

VLERËSIMI I KURRIKULËS SË ARSIMIT TË LARTË

sipas perspektivës së
përgatitjes profesionale
të mësimeve të
të ardhshme për
edukimin efektiv
të EQD-së/EDNJ-së
në përputhje me
standardet e KiE-së

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

VLERËSIMI I KURRIKULËS SË ARSIMIT TË LARTË

sipas perspektivës së
përgatitjes profesionale
të mësimdhënësve
të ardhshëm për
edukimin efektiv
të EQD-së/EDNJ-së
në përputhje me
standardet e KiE-së

Mendimet e shprehura në këtë publikim janë përgjegjësi e autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare të Këshillit të Evropës.

Riprodhimi i fragmenteve (deri në 500 fjalë) është i autorizuar, nëse nuk bëhet për qëllime komerciale dhe për aq kohë sa ruhet integriteti i tekstit, nuk nxirret jashtë kontekstit, nuk jep informacion të paplotë ose nuk e keqorienton lexuesin në lidhje me natyrën, objektin apo përmbajtjen e tekstit.

Përgatitur brenda fushës së zbatimit të projektit “Forcimi i edukimit për qytetari demokratike në Shqipëri”, i financuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida).

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTIMEVE	4
1. HYRJE	5
2. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME MBI ARSIMIN E LARTË NË SHQIPËRI	7
3. EDUKIMI I MËSIMDHËNËSVE PËR PËRGATITJEN E TYRE PARA SHËRBIMIT	9
4. METODOLOGJIA	11
5. LEGJISLACIONI KOMBËTAR PËR ARSIMIN E LARTË DHE EQD/EDNJ	13
6. PËRMBLEDHJE E DOKUMENTEVE TË KiE-së PËR EQD-në/EDNJ-në	15
7. GJETJET KRYESORE	21
8. ANALIZA E PËRMBAJTJES MBI EQD-në/EDNJ-në: TRI RASTE STUDIMORE	23
8.1 Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës: Fakulteti i Edukimit	23
8.1.1 Programe Bachelor dhe përputhshmëria me EQD-në	24
8.1.2 Programe master dhe përputhshmëria me standardet e EQD-së	26
8.2 Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan	27
8.2.1 Programet Bachelor në përputhshmëri me EQD-në	31
8.2.2 Programet master në përputhshmëri me standardet e EQD-së	34
8.3 Universiteti i Tiranës	36
8.2.1 Programet Bachelor në përputhshmëri me EQD-në	31
9. PRAKTIKA PROFESIONALE GJATË TRAJNIMIT PARA SHËRBIMIT	41
10. PËRFUNDIME	43
11. REKOMANDIME	45
12. BIBLIOGRAFI	47

LISTA E SHKURTIMEVE

ASCAP	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar ¹
KiE	Këshilli i Evropës
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
EQD	Edukimi për qytetari demokratike
BE	Bashkimi Evropian
ECTS	Sistemi Evropian për Transferimin e Krediteve
EDNJ	Edukimi për të drejtat e njeriut
IZHA	Instituti për Zhvillimin e Arsimit
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
KRKKD	Kuadri i Referencës për Kompetencat për Kulturë Demokratike
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
KDF	Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve
UNESCO	Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e Kombeve të Bashkuara

1. Kjo agjenci u themelua në vitin 2019, me urdhrin nr. 25, datë 27.2.2019, *Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor* (MAS, 2018-2) dhe me VKM-në nr. 98, datë 27.2.2019, *Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar* (QBZ, 2019), duke zëvendësuar Institutin e Zhvillimit të Arsimit (IZHA). Shkurtime ASCAP dhe IZHA, që përdoren në këtë tekst, u referohen të njëjtit institucion.

1. HYRJE

Ky raport është hartuar në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës (KiE) “Forcimi i edukimit për qytetari demokratike në Shqipëri” dhe është financuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Projekti synon përmirësimin e cilësisë së arsimit në Shqipëri, përmes forcimit të kapacitetit të sistemit arsimor, për të zhvilluar kompetencat e nxënësve të shkollës për kulturë demokratike, në përputhje me objektivat e politikave kombëtare, si dhe me standardet dhe praktikatat e Këshillit të Evropës. Duke u mbështetur në veprimtaritë e mëparshme të Këshillit të Evropës në Shqipëri dhe në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS), projekti mbështet reformën e vazhdueshme kurrikulare dhe qasjet e reja arsimore që ajo përfshin, të tilla si: metodat arsimore me bazë kompetencat dhe mësimdhënien me në qendër studentin.

Trajnimi fillestar i mësuesve përbën fazën e parë të rëndësishme të rrugëtimit profesional të mësuesve drejt misionit kryesor të tyre. Ai përfaqëson themelin e të menduarit në mënyrë profesionale, si dhe i pajis mësuesit me një sërë aftësish bazë për ta bërë mësimdhënien në klasë vërtet efektive. Trajnimi fillestar i mësuesve është faktor kyç në rritjen e cilësisë së mësimdhënies për të përmirësuar rezultatet e studentëve dhe për ta bërë shkollën shumë të suksesshme. Ndërhyrja e hershme në procesin e trajnimit të mësuesve, duke përdorur qasjen EQD/EDNJ është kusht i domosdoshëm për përmbushjen e misionit të arsimit si e mirë publike, për mirëfunksionimin e mbarë shoqërisë dhe për përparimin e demokracisë.

Përgjatë dekadës së fundit në Shqipëri nuk janë kryer studime të ngjashme, duke e bërë kështu këtë dokument studimin bazë, i cili mund të zhvillohet dhe pasurohet më tej. Në analizën e detajuar paraqitet shqyrtimi gjithëpërfshirës i integritetit të EQD-së/EDNJ-së në kurrikulën e arsimit të lartë në formimin fillestar të mësuesve të fakulteteve në Tiranë, Elbasan dhe Durrës. Studimi ka për qëllim të identifikojë mundësitë dhe sfidat që mund të çojnë në harmonizimin e kurrikulës zyrtare, të praktikave të mësimdhënies dhe të proceseve të zhvillimit të politikave me parimet e EQD-së. Analiza mbështetet si në rrafshin përshkruar ashtu dhe në atë analitik.

2. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME MBI ARSIMIN E LARTË NË SHQIPËRI

Përgjatë viteve të fundit, Shqipëria ka bërë progres të vazhdueshëm në zhvillimin dhe harmonizimin e politikave e praktikave të saj arsimore me standardet ndërkombëtare. Në përgjithësi, politikat arsimore kanë mbështetur përfshirjen e nismave të EQD-së/EDNJ-së, për të siguruar mësues të mirëtrajnuar e të aftë për kuptimin dhe transmetimin e EQD-së/EDNJ-së në mënyrë sa më efektive. Megjithatë, arsimi i lartë në Shqipëri është përballur me ndryshime të shumta në qeverisje dhe në nivele strukturore e kurrikulare.

Arsimi i lartë në Shqipëri ka njohur masivitet të skajshëm krahasuar me kapacitetet që zotëron dhe mundësitë që ofron. Ky zgjerim, pavarësisht se është konsideruar si domosdoshmëri, nuk ka ndodhur në faza të mirëmenduara, të planifikuara qartë e me kujdes, të cilat kalojnë gradualisht nga njëra tek tjetra. Në bazë të statistikave ndërkombëtare, Shqipëria ka një numër relativisht të madh institucioneve arsimore të larta për 1000 banorë, në krahasim me vende të tjera të zhvilluara. Ky fakt ka sjellë rënie të cilësisë, ndonjëherë në nivel dramatik dhe, për rrjedhojë, në mosarritjen e rezultateve të synuara.

Sistemi i arsimit të lartë në Shqipëri përbëhet nga 59² institucione: 15 institucione publike dhe 44 jopublike, nga të cilat 19 janë universitete. Numri i programeve të ofruara është afërsisht 1560, nga të cilat 700 ofrohen nga institucione publike të arsimit të lartë. Sa u përket niveleve të studimit, ekzistojnë 650 programe në ciklin e studimit *Bachelor*, rreth 250 programe studimi në ciklin *master profesional*, 350 programe në *master shkencor* dhe rreth 100 programe në ciklin e tretë (studimet doktorale).³

Problemet e rënda në arsimin e lartë në Shqipëri shkaktohen kryesisht nga mungesa e harmonizimit mes sistemit publik dhe atij jopublik, gjë që duket qartë në numrin e lartë të institucioneve arsimore, në shpërndarjen e programeve studimore dhe në numrin e studentëve. Gjithashtu, i gjithë procesi i provimeve të *maturës shtetërore* ka nxjerrë në pah qartësisht mangësitë mes zgjedhjes së programeve studimore të studentëve dhe programeve që ata realisht ndjekin. Mes programeve të ofruara vërehen dallime të mëdha; oferta kurrikulare nuk është e ngjashme, gjithashtu, edhe numri i studentëve ndryshon shumë. Kurrikulat (e të njëjtave programeve dhe me të njëjtin emërtim) nuk janë harmonizuar në nivel kombëtar dhe shpesh ka mbivendosje të ofertës akademike.

2. Raporti për Reformimin e Arsimit të Lartë në Shqipëri, Komisioni për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, korrik 2014.

3. Strategjia Kombëtare për Arsimin e Lartë (SCALA 2008-2013).

3. EDUKIMI I MËSIMDHËNËSVE PËR PËRGATITJEN E TYRE PARA SHËRBIMIT

Përgjatë dekadave të fundit, mësimdhënësit në Shqipëri janë gjendur në realitete të reja dhe iu është dashur të përmbushin kërkesa të reja për kualifikimet e tyre. Programet e vjetra arsimore për mësimdhënien ishin 4-vjeçare. Ligji për arsimin e lartë⁴ parashikon programe studimi *Bachelor* trevjeçare (180 ECTS) dhe kërkon që të gjithë mësimdhënësit të ndjekin studime pasuniversitare në fushat përkatëse. Prandaj, mësuesit e arsimit parashkollor dhe fillor (cikli i arsimit të ulët) pritet të kryejnë një program studimi *master profesional* (60-90-120 ECTS) dhe mësuesit e arsimit të mesëm duhet të kryejnë një program *master shkencor* (120 ECTS). Programet e nivelit të mesëm duhet t'i përlllogarisin 20% të të gjitha krediteve për formimin e përgjithshëm psikologjik dhe pedagogjik dhe 80% të tyre për njohuritë e specializuara që sigurojnë specialistë në mësimdhënie. Të gjithë arsimtarët duhet, gjithashtu, t'i nënshtrohen një provimi shtetëror përpara se të marrin licencën për mësimdhënie.

Shumë studime e kanë identifikuar si problem qendror mungesën e harmonizimit të programeve të trajnimit të mësuesve para shërbimit në institucionet publike me ato private. Një studim i kryer nga IZHA-ja⁵, më 2016-n, zbuloi vështirësi të konsiderueshme në harmonizimin e programeve studimore me kriteret e ligjit dhe me kurrikulën e re të bazuar në kompetenca. Gjithashtu, programet e ofruara nga universitetet e ndryshme në mbarë vendin kishin pak ose aspak ngjashmëri me njëri-tjetrin; konkretisht, shtatë universitete⁶ duhet të harmonizojnë programet e tyre.

Gjatë fazës së parë të përgatitjes së mësimdhënësve, kurrikula zakonisht mbingarkohet, duke i kushtuar pak vëmendje programeve ose praktikave të veçanta, që mund të jenë vërtet të dobishme për mësimdhënësit e ardhshëm. Praktika e mbikëqyrur e mësimdhënies, *Praktika profesionale*, shpesh neglizhohet. Trajnimi gjatë shërbimit nuk do të kishte përfitime, nëse nuk do t'i kushtohej vëmendja e duhur trajnimit para shërbimit. Ndërkohë që kërkesa për mësimdhënës të cilësisë së mirë është në rritje, përgatitja e mësimdhënësve të rinj po përballet me dy probleme të rëndësishme⁷: i) strukturat e fragmentuara – programet për mësimdhënësit ofrohen nga shtatë fakultetet e shkencave të edukimit; dhe ii) nivelet e ndryshme të cilësisë, si dhe përmbajtja pedagogjike e akademike e programeve.

4. Ligji nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".
5. Raport për arsimimin e mësimdhënësve para shërbimit në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri, IZHA, 2016.
6. Tiranë, Durrës, Shkodër, Elbasan, Korçë, Vlorë, Gjirokastrë.
7. Raport për arsimimin e mësimdhënësve para shërbimit në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri, IZHA, 2016.

4. METODOLOGJIA

Në fazën e parë u përzgjedhën për t'u analizuar programet e studimit të fakulteteve që përgatisin mësimdhënës. Procesi përfshinte analizimin online të shtatë fakulteteve të edukimit/mësimdhënies në Shqipëri, me qëllim marrjen e njohurive të mundshme mbi detajet kurrikulare lidhur me EQD-në/EDNJ-në.

Tri fakultet e mësimdhënies, në Tiranë, Elbasan dhe Durrës, iu nënshtruan një shqyrtimi të detajuar të programeve studimore dhe kurseve të tyre mësimore. Universiteti i Tiranës u përzgjedh si universiteti më i madh qendror në Shqipëri; Universiteti i Elbasanit si universiteti kryesor, i cili historikisht ka përgatitur mësimdhënës; dhe Universiteti i Durrësit, si një nga universitetet e ngritur vitet e fundit.

Në fazën e dytë, u zhvillua metodologjia e analizimit të programeve të mësimdhënësve para shërbimit, duke përfshirë përmbajtjen, objektivat e mësimi, orët e mësimdhënies dhe metodat e mësimdhënies.

Metodologjia e kërkimit kishte për qëllim t'u përgjigjej pyetjeve kryesore kërkimore të mëposhtme:

Në bazë të kurrikulës së shkruar, a i përgatit edukimi para shërbimit mësuesit për të kuptuar dhe për të zbatuar parimet EQD/EDNJ në shkollë?

Për t'iu përgjigjur pyetjes kryesore, u adresuan nënpyetjet e mëposhtme:

- a) A përmban edukimi para shërbimit:
 - njohuri⁸ mbi të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe mbi të drejtat e fëmijëve në veçanti, si dhe njohuri mbi grupet e tjera vulnerabël;
 - njohuri mbi demokracinë, si: sistemi, vlerat, institucionet, modelet;
 - njohuri mbi (të drejtën për) pjesëmarrjen – në familje, shkollë, komunitet – qeverisje dhe vendimmarrje;
 - njohuri mbi shtetin e së drejtës, drejtësinë sociale, barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin;
 - njohuri mbi të menduarin kritik, si: i menduari analitik, mësimi i pavarur;
 - njohuri mbi parimet dhe praktikatat e arsimit gjithëpërfshirës;
 - njohuri mbi diversitetin kulturor, si: toleranca dhe mendësia e hapur;
 - njohuri mbi komunikimin efektiv;
 - njohuri mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.
- b) A i mbulon kurrikula temat e lartpërmendura dhe a janë të mjaftueshme orët e caktuara për trajtimin e tyre?
- c) A mësojnë mësuesit-studentë (praktikantët) rreth metodave⁹ që mund të përdoren për mbështetjen e EQD-së në shkollë?
 - Metodologjitë e drejtuara me në qendër nxënësin/studentin;

8. Lloji i njohurisë.

9. Lloji i metodologjisë.

- Qasjet me bazë të drejtat njerëzore të nxënësin/studentit;
- Metodologjitë interaktive e gjithëpërfshirëse;
- Vendimmarrje e bazuar në dijen e përbashkët (në nivele kurrikulare, strukturore dhe qeverisjeje);

d) A iu jepet mundësi për t'i zbatuar ato gjatë përgatitjes së tyre para shërbimit?

e) A marrin të gjithë mësuesit-studentë të njëjtin nivel përgatitje?

- Diferencat mes universiteteve të ndryshme;
- Kurse të detyrueshme kundrejt atyre me zgjedhje.

Në metodologjinë kërkimore janë përdorur metoda të përziera, që përfshijnë studimin me bazë dokumentacionin, duke e plotësuar nga intervistat me aktorët kryesorë. Programet studimore dhe programet mësimore të kurseve u analizuan, duke përdorur metodat e analizimit të përmbajtjes. Analizimi i përmbajtjes u bë me përparësi në ato lëndë universitare, të cilat janë të përshtatshme për EQD-në/EDNJ-në.

Studimi i dokumentacionit u përqendrua në shqyrtimin e studimeve të mëparshme, të dokumenteve relevante strategjike dhe ligjore, të kurrikulës së shkruar dhe të programeve mësimore të kurseve të zgjedhura të tri fakulteteve të marra në shqyrtim. Studimi i dokumenteve të KiE-së, që siguron standardet e nevojshme për vlerësimin e nivelit të përgatitjes së mësimdhënësve, por edhe vizionin për forcimin e kompetencave, qëndrimeve dhe praktikave profesionale të mësimdhënësve, shërbeu për hartimin e standardeve dhe praktikave kundrejt të cilave u vlerësua kurrikula e arsimit të lartë dhe objektivat e mësimin.

Vlerësimi u kufizua kryesisht në fushën e kurrikulës së shkruar zyrtare. Kurrikulat e zhvilluara dhe të zbatuara nuk ishin pjesë e vlerësimit, ndonëse disa informacione rreth tyre u morën përmes intervistave.

Informacioni i drejtpërdrejtë u mblodh nga dhjetë intervista me përgjegjësit e departamenteve të edukimit/mësimdhënies dhe me profesorë të universiteteve të përzgjedhura.

Rezultatet dhe rekomandimet u përditësuan dhe u verifikuan më tej, pas zhvillimit të konsultimit të zgjeruar në katër tryeza të rrumbullakëta, që u organizuan në kuadër të projektit "Forcimi i edukimit për qytetari demokratike në Shqipëri".

Konceptet kyçe të EQD-së, që u shqyrtuan në programet studimore dhe në programet mësimore të kurseve, ishin:

- ▶ demokracia;
- ▶ pjesëmarrja;
- ▶ bashkëpunimi;
- ▶ kompetenca;
- ▶ barazia (përfshirë atë gjinore);
- ▶ toleranca;
- ▶ mësimi gjatë gjithë jetës.

Në kryerjen e vlerësimit, nuk pati kufizime serioze, përveç mungesës së aksesueshmërisë në disa informacione dhe programe universitare, gjë e cila ishte e pashmangshme për shkak të pandemisë COVID-19, si dhe pushimeve verore. Për të siguruar akses në këto dokumente, u shkëmbyen *e-mail*-e, komunikime përmes telefonatash dhe u bënë takime ballë për ballë me pedagogë të universiteteve.

5. LEGJISLACIONI KOMBËTAR PËR ARSIMIN E LARTË DHE EQD-në/EDNJ-në

Përgjatë viteve të fundit, janë bërë përpjeke të shumta për ta ngritur arsimin e lartë në Shqipëri në nivelin e standardeve ndërkombëtare. Qasjet kryesore strategjike, që janë përdorur në arsimin e lartë, kanë pasqyruar prirjet aktuale të arsimit të lartë në mbarë botën dhe veçanërisht, në Evropë, duke synuar kështu maksimizimin e përfshirjes së Shqipërisë në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë. Megjithatë, shumë aspekte të arsimit të lartë e konkretisht: cilësia e mësimdhënies, përmbajtja e kurrikulës dhe kërkimi shkencor në institucionet e arsimit të lartë janë kundërshtuar gjerësisht në bazë të shqetësimeve të ngritura se si u përgjigjen ato nevojave sociale, kulturore dhe ekonomike të vendit.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë mbështet plotësisht vlerat dhe parimet e EQD-së/EDNJ-së. Kushtetuta deklaron, se: *“të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik dhe organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të kontribuojnë në realizimin e tyre”*¹⁰. Kushtetuta adreson të drejtën e arsimimit për këdo dhe të drejtën për ndjekjen e arsimit parauniversitar përmes shkollave publike.

Ligji për arsimin e lartë në Shqipëri¹¹ (neni 1/B) deklaron, se: *“Misioni i arsimit të lartë është të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend”*. Ligji bazohet kryesisht në procedura dhe dispozita rregullatore, për sa i përket mënyrës se si institucionet e arsimit të lartë duhet ta transmetojnë dijen dhe i kushton pak rëndësi llojeve të njohurive dhe parimeve të dijeve, që institucionet e arsimit të lartë duhet të përhapin.

VKM-të vijuese të ligjit shpjegojnë me hollësi procedurat e bashkëpunimit të institucioneve, kompetencat e tyre, financimet, agjencitë etj. Në përgjithësi, vetë ligji është procedural dhe nuk mbulon aspekte të tilla, si parimet dhe standardet e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe shtetit të së drejtës. EQD-ja nuk përmendet qartësisht në asnjë nga paragrafët e veçantë të ligjit. Megjithatë, përmes parimit të “autonomisë”, ligji u mundëson universiteteve dhe institucioneve të arsimit të lartë t’i bëjnë parimet e EQD-së pjesë të kurrikulës dhe të filozofisë së tyre të drejtimit. Kjo ka ndodhur sa herë që departamentet e universiteteve kanë marrë vendimet e tyre dhe kanë nxjerrë përparësitë kurrikulare, duke marrë parasysh interesin më të mirë të studentëve.

10. Neni 15 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

11. Ligji për arsimin e lartë nr. 80/2015.

Ligji për rininë¹² është një tjetër ligj i rëndësishëm, që duhet të trajtohet me kujdes brenda kuadrit të etikës për EQD-në/EDNJ-në. Qysh në fillim, (neni 1/2) theksohet, se: *“mbrojtja e të drejtave të të rinjve përmes politikave gjithëpërfshirëse, që çojnë në krijimin e kushteve të favorshme për pjesëmarrjen efektive dhe aktive”*. Ligji mbështetet në parime, të tilla si: mosdiskriminimi, mundësitë e barabarta, liria e shprehjes dhe e grumbullimit, të gjitha këto në përputhje me vlerat e KiE-së. Megjithatë, (neni 3/B) përkufizimi për “Edukimin joformal si çdo veprimtari e organizuar dhe e përshtatur për të rinjtë, jashtë sistemit formal të arsimit”¹³, përjashton edukimin joformal përmes kurrikulës dhe e lë këtë lloj edukimi jashtë planit të miratuar të veprimit të institucioneve. Në të vërtetë, edukimi joformal shihet ende si lloji i edukimit përtej skemës formale kurrikulare. Ligji nuk bën rekomandime të posaçme për asnjë lloj veprimtarie joformale që të rinjtë mund të bëjnë, në bazë të të drejtave të tyre, në institucionet e arsimit të lartë.

Strategjia Kombëtare për Arsimin e Lartë (datë 2008–2013) nuk është përditësuar. Filozofia e strategjisë së mëparshme (neni 2/24), vizioni i saj, prioritetet dhe objekti i arsimit të lartë janë mishëruar në mënyrë të qartë në: *“zhvillimin e shoqërisë dhe promovimin e standardeve demokratike përmes edukimit të studentëve për përfshirje aktive qytetare”*. Në dokument parashtrohen qartë parimet e EQD-së dhe të EDNJ-së dhe theksohet fakti se mësimdhënia në disa universitete nuk është e orientuar drejt aftësisimit profesional, duke theksuar veçanërisht mësimdhënien në arsimin fillor.

Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar (2014–2020) është një tjetër dokument kyç, që përfaqëson prioritetet kombëtare arsimore dhe mënyrat drejt përmirësimit të aksesit në sistemin arsimor, të shërbimit, cilësisë dhe gjithëpërfshirjes në bashkëpunim me standardet ndërkombëtare. Strategjia ka tri shtylla kryesore: përmirësimi i edukimit fillestar të mësuesve dhe zhvillimi profesional i mësuesve, kurrikula me bazë kompetencat dhe transformimi në një platformë për përfshirje sociale.

12. Ligji për të rinjtë nr. 75 /2019.

13. Në përputhje me përkufizimin e KiE-së në Kartën për EQD-në.

6. PËRMBLEDHJE E DOKUMENTEVE TË KiE-së PËR EQD-në/EDNJ-në

Këshilli i Evropës njihet si një nga organizatat ndërkombëtare më të rëndësishme që ka investuar në arsim, duke e konsideruar atë thelbësor në zhvillimin e një shoqërie të rregullt dhe të qëndrueshme.

E drejta për arsimim gjendet në thelb të **Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut**. Neni 2, i protokollit të parë, i shtuar në *Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Liritë Themelore*, garanton të drejtën për arsimim, duke u shprehur se: *“Askujt nuk mund t’i mohohet e drejta për arsimim. Shteti, në ushtrimin e funksioneve që merr përsipër në fushën e edukimit dhe të arsimit, respekton të drejtën e prindërve për të siguruar këtë edukim dhe arsim në përputhje me bindjet e tyre fetare dhe filozofike.”* Fusha e zbatimit dhe përmbajtja e këtij protokollit kanë për qëllim të theksojnë dhe të forcojnë të drejtat themelore, duke e konsideruar arsimin një prej tyre. Përmes tij, KiE-ja i “fton” shtetet anëtare të veprojnë në mënyrë të përshtatshme në drejtim të aksesit dhe cilësisë së arsimit. Duke parë përmes perspektivës së EQD-së, arsimi duhet të jetë një proces që zhvillohet në përputhje të plotë me bindjet fetare dhe filozofike të vetë shteteve. Kjo lidhje nuk shfaqet kaq e dukshme në asnjë dokument tjetër evropian ose dhe ndërkombëtar.

Dokumentet zyrtare e KiE-së për EQD-në/EDNJ-në i trajtojnë konceptet e EQD-së/EDNJ-së në përgjithësi dhe në veçanti, si teorikisht ashtu edhe praktikisht.

Një nga dokumentet themelore, që trajton kompetencat e mësuesve në fushën e EQD-së, është **Kuadri i Referencës për Kompetencat për Kulturë Demokratike**. Ai ndahet në shtatë seksione dhe trajton konceptin e kulturës demokratike sa i përket edukimit, duke ofruar një skemë me njëzet kompetenca në fushën e kulturës demokratike dhe duke sjellë kështu modele të qarta të përfshirjes së tyre në kurrikula të ndryshme e në nivele të ndryshme arsimore. Dokumenti përmban vlerat, qëndrimet, besimet dhe njohuritë e nevojshme për pjesëmarrjen efektive të çdo qytetari në një kulturë demokratike.

Sa i përket trajnimit fillestar të mësuesve, dokumenti është i një rëndësie të veçantë, pasi krijon një kornizë të përbashkët kompetencash për mësuesit-studentë. Ai kontribuon në mënyrë të drejtpërdrejtë në hartimin dhe zbatimin e kurrikulës me bazë kompetencat dhe të standardeve profesionale gjatë trajnimit fillestar të mësuesve. Kuadro të tilla kompetencash nevojiten si bazë për harmonizimin e kurrikulës gjatë përgatitjes fillestare të mësuesve; për përcaktimin e rezultateve të të nxënit në programet e trajnimit fillestar të mësuesve; për vendosjen e kriterëve në përzgjedhjen dhe në punësimin e mëtejshëm të mësuesve; për angazhimin e institucioneve të arsimit të lartë në zhvillimin profesional të mësuesve gjatë shërbimit të tyre; dhe për sigurimin e mundësisë profesionale, në mënyrë që mësuesit të mund të vazhdojnë ushtrimin e kompetencave gjatë gjithë karrierës së tyre.

Karta e Këshillit të Evropës për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe Edukimin për të Drejtat e Njeriut flet në terma më konkretë për EQD-në dhe për konceptet e tjera që lidhen me të.

“Edukimi për qytetari demokratike” nënkupton edukimin, trajnimin, ngritjen e vetëdijes, informimin, praktikat dhe veprimtaritë që ato synojnë përmes pajisjes së nxënësve me njohuri, aftësi, qëndrime dhe sjellje që i aftësojnë dhe i fuqizojnë ata për të ushtruar dhe për të mbrojtur të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në shoqëri, për të vlerësuar diversitetin dhe për të luajtur një rol aktiv në jetën demokratike, për mbrojtjen dhe përparimin e demokracisë dhe të shtetit të së drejtës.”

Duke ditur se konceptet e lidhura me EQD-në mund të jenë shumë të ngjashme mes tyre, Karta përpiket të shpjegojë ndryshimet sipas koncepteve të mëposhtme:

Edukimi për qytetari demokratike	Edukimi për të drejtat e njeriut
Përqendrohet kryesisht te të drejtat dhe përgjegjësitë demokratike dhe pjesëmarrja aktive, në lidhje me sferat qytetare, politike, shoqërore, ekonomike, ligjore dhe kulturore të shoqërisë.	Lidhet me një spektër më të gjerë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në çdo aspekt të jetës së tij.

Ekzistojnë edhe disa përbërës tepër të rëndësishëm të EQD-së që kjo Kartë i konsideron thelbësorë:

“Përbërës thelbësor i të gjithë edukimit për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut është zhvillimi i kohezionit shoqëror, i dialogut ndërkulturor dhe vlerësimi i diversitetit dhe i barazisë, përfshi këtu edhe barazinë gjinore; për këtë qëllim, është e rëndësishme të zhvillohen njohuri, aftësi vetjake dhe shoqërore që do të pakësojnë konfliktet, do të rrisin vlerësimin dhe mirëkuptimin e ndryshimeve ndërmjet grupeve etnike dhe fetare, do të ndërtojnë respektin e ndërsjellë për dinjitetin njerëzor dhe vlerat e përbashkëta, do të nxisin dialogun dhe mospërdorimin e dhunës në zgjidhjen e konflikteve dhe të mosmarrëveshjeve”.

Përveç listës së përbërësve thelbësorë, Karta thekson synimet themelore të EQD-së: *“Një ndër synimet themelore të edukimit për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut është jo thjesht të pajisë nxënësit me njohuri dhe aftësi, por edhe t’i fuqizojë ata me gatishmërinë për të ndërmarrë veprime për mbrojtjen dhe për zhvillimin e të drejtave të njeriut, të demokracisë dhe të shtetit të së drejtës”.*

Karta u kërkon shteteve anëtare të zhvillojnë strategji që garantojnë përfshirjen e standardeve të EQD-së në çdo nivel edukimi, veçanërisht në sistemin e arsimit të lartë, duke theksuar vazhdimisht se EQD-ja është një proces që zgjat gjatë gjithë jetës.

Një tjetër dokument i rëndësishëm, **Edukimi për demokraci, materialet mbështetëse të edukimit për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut për mësuesit** (2010), analizon hollësisht EQD-në, duke qartësuar konceptin e edukimit për qytetari demokratike, duke bërë një analizë të thellë të tij, si dhe duke ofruar modele dhe

praktika për t'u ndjekur. Ndonëse kompetencat që studentët duhet të përftojnë në kuadër të EQD-së janë dinamike, ky dokument i ndan ato në tri seksione:

- kompetencat për analizën dhe gjykimin politik;
- kompetencat për përdorimin e metodave;
- kompetencat për vendimmarrjen dhe veprimin politik.

Këto grupe kompetencash duhet t'i perceptojmë si një proces. Gjatë të gjitha niveleve arsimore, studentëve duhet t'u mundësohet ta kuptojnë konceptin, ta përdorin atë dhe të marrin veprimet e duhura në bazë të njohurive të fituara: kupto, zbat, vepron!

Ajo çka është më interesante është se ky material e paraqet EQD-në jo vetëm si lëndë kurrikulare, por edhe si çështje etike në arsimim, administrim dhe zhvillim. Edukimi për qytetari demokratike nuk duhet të jetë thjesht një koncept/lëndë/veprimtari e përfshirë në kurrikul, por edhe pjesë e kontekstit më të gjerë të arsimit, administrimit dhe zhvillimit.

Qeverisja demokratike e shkollave, janar 2007, përfshin një koncept të ri, që lidhet fort me EQD-në, siç është *qeverisja demokratike e shkollave* dhe përdoret në gjithë manualin si përkufizim i gjerë i udhëheqjes së shkollave, duke përfshirë aspektet ligjore dhe ideologjike. *Qeverisje "demokratike" e shkollave* do të thotë se qeverisja e shkollës bazohet në vlerat e të drejtave të njeriut, autorizimin dhe pjesëmarrjen e nxënësve, personelit dhe palëve të tjera të interesuara në marrjen e vendimeve të rëndësishme në shkollë. Në këtë material tregohet se *vlerat e EQD-së/EDNJ-së* shprehen jo vetëm në kurrikulën e shkruar, por edhe si elemente themelore dhe qendrore të funksionimit të jetës shkollore. Tipari dominues i shkollës, bazohet në spikatjen e barazisë dhe respektimin e të drejtave të njeriut: udhëheqësit e shkollave "me veprim vetjak" u tregojnë të tjerëve për demokracinë dhe respektin. Teksa lexojmë këtë paragraf, zbulojmë se pavarësisht ofrimit të disa metodave dhe qasjeve të mësimdhënies, faktikisht, mësimdhënësit i zgjedhin vetë metodat e mësimdhënies. "*Mësimdhënësit punojnë shumë më mirë kur përgatisin metodat e tyre mësimore*". Është e rëndësishme të kuptohet se mësimdhënësit duhet të fokusohen tek EQD-ja, por duhet të jenë fleksibël ndaj metodave që përdorin në varësi të kontekstit të jetës së tyre.

Dokumenti i KiE-së, **Udhëzime për edukimin global, një udhëzues për edukatorët për të kuptuar dhe për të zbatuar në praktikë edukimin global** trajton dokumentet universale dhe parimet e KiE-së, si dhe lidh konceptin e edukimin global me atë të EQD-së: "*Edukimi global është edukimi që hap sytë dhe mendjet e njerëzve ndaj realiteteve të botës, i zgjon ata për të sjellë një botë me më shumë drejtësi, barazi dhe të drejta të njeriut për të gjithë. Edukimi global, duke qenë përmasa globale e edukimit për qytetari, përmbledh edukimin për zhvillim, edukimin për të drejtat e njeriut, edukimin për qëndrueshmëri, edukimin për paqe dhe parandalim konflikti dhe edukimin ndërkulturor*".

Rekomandimi i KiE-së CM/Rek. (2012)13 për sigurimin e cilësisë në arsim ofron një angazhim të fortë ndaj qasjes së EQD-së si pjesë e arsimit cilësor, duke i lidhur këto dy koncepte me synimin për të siguruar arsim më të mirë në çdo vend. "*Duke pasur parasysh se arsimi duhet t'i përgatisë fëmijët dhe të rinjtë për qytetari demokratike, si dhe për veprimtari ekonomike; që duhet të nxisë zhvillimin e mëtejshëm vetjak të nxënësve dhe të studentëve, si dhe rritjen e tyre si anëtarë aktivë të shoqërisë; që duhet të zhvillojë dhe të sigurojë aftësitë gjuhësore, numerike dhe konjitive (njohëse), të cilat janë baza e të nxënësve*

të suksesshëm të të gjitha lëndëve; duke pasur parasysh se arsimimi është vendimtar në zhvillimin e kulturës demokratike për të cilën institucionet dhe shoqëritë demokratike kanë nevojë që të funksionojnë; duke pasur parasysh që arsimimi duhet t'u mundësojë nxënësve dhe studentëve të zhvillojnë aftësi të shkëlqyera në dialogun ndërkulturor; duke pasur parasysh se në shoqëritë demokratike, çdokush duhet të gëzojë mundësi të barabarta, në mënyrë që ata mund ta ushtrorjnë të drejtën e tyre për arsimim dhe të përfitojnë nga arsimit cilësor, në përputhje me aspiratat dhe aftësitë e tyre; duke pasur parasysh se në demokraci komplekse dhe moderne, autoritetet publike mund ta përmbushin këtë përgjegjësi në mënyrë të ndryshme". Në këtë dokument të KiE-së përcillet mesazhi se synimi final i arsimit cilësor është forcimi i të rinjve me kulturën e qytetarisë demokratike. Nga ky këndvështrim, KiE-ja u kërkon të gjitha shteteve anëtare të marrin masat e duhura për zbatimin e dispozitave të këtij rekomandimi dhe të dokumenteve të tjera të rëndësishme, si dhe të zhvillojnë strategjitë e tyre kombëtare.

Rekomandimi KM/Rek. (2007)13 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi integrimin e çështjeve gjinore në arsim (miratuar nga Komiteti i Ministrave, më 10 tetor 2007, në takimin e 1006 të zëvendësministrave) e lidh EQD-në me fokusin gjinor, duke mbështetur kështu idenë se edukimi i suksesshëm për qytetari demokratike duhet domosdoshmërisht të përqendrohet në çështjet gjinore dhe thekson mesazhin se edukimi i grave mund të çojë në shoqëri më të mira. Ky rekomandim thekson, se: "Të ndërgjegjshëm për përgjegjësinë që kanë sistemet arsimore për edukimin e nxënësve/studentëve për pjesëmarrje aktive në aspekte të ndryshme të jetës demokratike, qofshin ato politike, qytetare, sociale ose kulturore dhe në të gjitha nivelet si vendore, rajonale dhe kombëtare; të ndërgjegjshëm se mësimdhënësit mund të bëhen agjentë të përjetësimin të mekanizmave të përzgjedhjes me bazë gjinore ose, nga ana tjetër, agjentë të ndryshimit social dhe se është thelbësore të përfshihen shkollat dhe pjesëmarrës të ndryshëm në procesin e arsimit për promovimin e barazisë gjinore; të ndërgjegjshëm që edukimi dhe trajnimi i mësimdhënësve është vendimtar në nxitjen e barazisë gjinore në arsim; të ndërgjegjshëm që, në shkollë, sfera joformale, konkretisht kurrikula e fshehur, është po aq e rëndësishme sa sfera formale në krijimin e identiteteve të vajzave dhe të djemve; të bindur se barazia mes grave e burrave dhe perspektiva gjinore duhet të përfshihet në të gjitha nivelet e sistemit të arsimit që në moshë të hershme, me qëllim nxitjen, mes vajzave dhe djemve, grave dhe burrave, të vlerave të drejtësisë dhe të pjesëmarrjes së nevojshme për ushtrimin efektiv dhe aktiv të qytetarisë demokratike dhe për krijimin e një partneriteti të sinqertë mes grave dhe burrave në sferat e tyre private dhe publike".

Ky rekomandim kërkon që shtetet anëtare të veprojnë, në mënyrë që integrimi gjinor të futet në të gjitha nivelet e arsimit, përmes marrjes së masave të posaçme dhe sigurimit të mekanizmave të monitorimit që garantojnë zbatimin e suksesshëm të masave të miratuara. Rekomandimi shkon përtej nivelit konceptual të integrimin gjinor në edukimin për qytetari demokratike, tek ai i mekanizmave të posaçëm të zbatimit, si pjesë e qasjes së qeverisë.

Pas rekomandimeve, KiE-ja e lidh EQD-në me parandalimin dhe luftimin e seksizmit. **Rekomandimi KM/Rek. (2019)1 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për parandalimin dhe luftimin e seksizmit** deklaroi qartësisht se vendet anëtare duhet "të sigurojnë hartimin dhe zbatimin e edukimit dhe trajnimeve të përshtatura dhe të vazhdueshme për edukatorë në të gjitha sferat dhe në të gjitha nivelet e arsimit, përfshirë institucionet arsimore, për personelin e burimeve njerëzore në sektorin publik

e atë privat dhe në institucionet e trajnimeve profesionale (për shembull: media, ushtri, profesionistët mjekësorë dhe juridikë dhe shkollat e kontabilitetit, menaxhimit dhe biznesit) për barazinë gjinore, kuptimin e stereotipave gjinorë, si të njohin dhe të adresojnë seksizmin, paragjykimet dhe njëanësinë dhe si të sfidohen stereotipet”.

Rekomandimet e KiE-së janë të aksesueshme jo vetëm nga qeveritë e shteteve, por edhe nga edukatorët/mësuesit, në mënyrë që ata të mund të zhvillojnë qasjen e tyre. Sipas këtyre dokumenteve, seksizmi është një qëndrim që ndeshet shpesh në sistemin arsimor. *“Mesazhet seksiste formësojnë shoqërinë tonë dhe janë të mbjella dhe të riprodhuara nga sistemet arsimore, aty ku ato duhet të sfidohen”.*

7. GJETJET KRYESORE

Programet studimore të fakulteteve që përgatisin mësime të ndryshme u janë nënshtruar reformave të thella, por, megjithatë, kurrikulat e shqyrtuara janë të ndryshme nga njëra-tjetra. Harmonizimi i kurrikulave në edukimin fillestar të mësimeve nuk është arritur ende, për shkak të qasjeve të ndryshme që kanë ndjekur institucionet e arsimit të lartë. Programet e përgatitjes së mësimeve në institucionet e arsimit të lartë, të shqyrtuara në këtë studim, përfshijnë kurse të ndryshme të shtrira në afate kohore të ndryshme dhe me peshë specifike të ndryshme në programet studimore.

Në bazë të analizës së programeve mësimore të kurseve të shqyrtuara, qasja kurrikulare është kryesisht me bazë në dijet dhe njohuritë e, pjesërisht, me bazë objektive dhe kompetencat. Termi **kompetencë** përmendet në mënyrë të paqartë dhe sporadike. Në tërësi, ka objektiva kurseve të shprehura si njohuri dhe, në disa raste të tjera, si aftësi. Kurrikula me bazë kompetencat, që formon bazën e sistemit të arsimit parauniversitar në Shqipëri, nuk zbatohet realisht në institucionet e arsimit të lartë. Universitetet nuk i kanë pasqyruar ende në programet e tyre çështjet e reformës të ngritura nga arsimit parauniversitar. Këto çështje trajtojnë konceptin e kompetencave kyçe në arsim, në mjediset e mësimi, në strukturën dhe përmbajtjen e programeve e të kurseve të reja, në planifikimin e mësimeve të bazuar në kompetenca, në vlerësimin e studentëve, në raportimin e arritjeve të studentëve, në nivelin e arritjeve etj.

Në nivel njohurish, kurrikula e shkruar zyrtarisht për të dyja ciklet e studimit është tejet e përshtatshme për standardet dhe parimet e edukimit për qytetari demokratike. Përgjatë viteve të tyre të studimit, mësuesit-studentë marrin njohuri të thella rreth kompetencave demokratike të lidhura me të drejtat e njeriut, qytetarinë, pjesëmarrjen, gjithëpërfshirjen, diversitetin, zgjidhjen e marrëveshjeve pa dhunë, të menduarin kritik etj.

Temat kryesore të EQD-së/EDNJ-së janë edhe pjesë e kurrikulës. Ato gjenden në çdo semestër dhe kanë numër të mjaftueshëm orësh. Kurset e lidhura me EQD-në/EDNJ-ë janë kryesisht të detyrueshme.

Në bazë të kurrikulës së shkruar, në nivel metodash, projektimi dhe qasja kurrikulare siguron informacion të plotë rreth mënyrave të zbatimit të njohurive teorike në praktikë lidhur me EQD-në/EDNJ-në. Pavarësisht ndryshimeve mes universiteteve, kurrikula e shkruar i përgjigjet metodologjive të mësimeve dhe qasjes me në qendër fëmijën/nxënësin, metodologjive interaktive dhe gjithëpërfshirëse, të cilat janë padyshim themelore për zbatimin e EQD-së/EDNJ-së.

Problemet kryesore gjenden në fushën e pedagogjisë (udhëzimi për mësime), e cila nuk është përgjithësisht në përputhje me standardet e edukimit për qytetari demokratike. Shumica e udhëzimeve të mësimeve në universitete janë formale, tradicionale, me profesorë ligjërues që flasin në podium dhe studentët që i dëgjojnë ata në mënyrë pasive. Leksionet që u lënë studentëve hapësirë të përfshihen, të reflektojnë dhe të mendojnë janë të rralla dhe kjo ndryshon shumë nga një profesor tek tjetri. Megjithatë, elementet e metodologjive interaktive janë të pranishme, veçanërisht

gjatë organizimit të seminareve. Gjithashtu, vërehet edhe prirja për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit gjatë leksioneve dhe seminareve.

Praktika profesionale (Teaching Practicum) ka nevojë për organizim, përmirësim dhe reformim të mëtejshëm, përmes krijimit të një partneriteti të shëndetshëm mes profesorëve, mësuesve-studentë dhe mësuesve mentorë. Duke ditur rëndësinë e praktikimit të njohurive dhe të aftësive brenda kuadrit të edukimit për qytetari demokratike dhe edukimit për të drejtat e njeriut, reformimi dhe përmirësimi i këtij procesi është me rëndësi të madhe.

Përputhshmëri më të lartë me standardet e EQD-së është vërejtur në dy cikle studimore: Mësimdhënia parashkollore dhe Mësimdhënia në arsimin fillor (klasat 1-5). Përputhshmëria është më e lartë për sa i përket larmisë dhe numrit të kurseve të ofruara, si dhe krediteve të dhëna. Ekspozimi i fëmijëve ndaj standardeve të EQD-së, që në fazat e hershme të edukimit të tyre, mund të çojë në një të ardhme premtuese në lidhje me performancën e tyre si qytetarë të mirë.

Kurrikulat e shkruara janë hartuar në bazë të parimit të barazisë gjinore. Kurset paraqesin mundësi për diskutimin e çështjeve, të tilla si: të drejtat e grave, rolet gjinore, diskriminimi gjinor, seksizmi dhe barazia gjinore. Ky rezultat u mbështet plotësisht nga çdo i anketuar i përfshirë në studim.

Të gjitha programet studimore (Bachelor, master) kanë të paktën një lëndë që u kushtohet koncepteve kyçe të EQD-së dhe kjo lëndë është e detyrueshme. Në shumë raste, ka më shumë se një lëndë të tillë.

Të menduarit kritik nxitet gjerësisht dhe studentët priten të luajnë një rol të rëndësishëm në drejtimin dhe në nivelin strukturor të procesit të vendimmarrjes. Qasja e Departamentit të Edukimit bazohet gjerësisht në të menduarin kritik, si parim thelbësor për zhvillimin e kompetencave për kulturë demokratike.

Kurrikulat e shkruara universitare u përgjigjen çështjeve bashkëkohore të debatueshme me natyrë të ndjeshme në nivel vendor, rajonal dhe global. Kurset e analizuara udhëhiqen nga parimet e hapjes dhe hyrjes në dialog me mësuesit-studentë për çështje komplekse e të debatueshme. Ata ushqejnë ndjeshmëri ndaj konteksteve lokale dhe inkurajojnë fleksibilitet në reagime. Gjithashtu, ata krijojnë mundësi që mësuesit-studentë të vetëreflektojnë mbi vlerat dhe vetëbesimin e tyre.

Ka një përqendrim të madh në disiplinat e "komunikimit" dhe në ato të "metodologjive të mësimdhënies", të cilat në shumicën e programeve studimore, janë përcaktuar si disiplina ndërsektoriale.

8. ANALIZA E PËRMBAJTJES MBI EQD-në/EDNJ-në: TRI RASTE STUDIMORE

8.1 UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS – FAKULTETI I EDUKIMIT

Fakulteti i Edukimit, i themeluar në vitin 2006, është relativisht i ri. Motoja e tij është “*Studenti në qendër*” dhe përqendrohet në trajnimin dhe në zhvillimin e vazhdueshëm të studentëve. Një aspekt i rëndësishëm i politikës së Fakultetit është transmetimi i vlerave njerëzore dhe qytetare, duke treguar përputhshmëri të plotë me standardet e EQD-së në qeverisje dhe nivel kurrikular.

Fakulteti i Edukimit përbëhet nga gjashtë departamente (duke përfshirë Departamentin e Pedagogjisë) dhe ofron:

- ▶ Shtatë programe studimi *Bachelor* të ciklit të parë: Mësimdhënie në arsimin parashkollor, Arsimi fillor (klasat 1–6), Gjuhë angleze dhe literaturë, Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane dhe angleze, Ekspert në proceset e trajnimit, Psikologji–sociologji.
- ▶ Tri programe studimi në ciklin e dytë *master*: master shkencor në Mësimdhënie të gjuhës angleze dhe literaturë, Administrim i institucioneve arsimore, Mësimdhënie psikologji–sociologji.
- ▶ Pesë programe studimi në ciklin e dytë *master*: master profesional në Arsimin fillor, Didaktikë, Mësimdhënie dhe literaturë e gjuhës angleze, Mësimdhënie e gjuhës angleze, Shërbim social dhe komunitar.

Nuk ka programe studimi të ciklit të tretë, doktoraturë.

Emri i kursit	ECTS	Viti i fillimit	Lloji i vlerësimit ¹⁴
<i>Edukimi për të drejtat e fëmijëve</i>	6	2013	<ul style="list-style-type: none">▶ Pjesëmarrja e studentëve është e detyrueshme për të paktën 25% të leksioneve dhe të seminareve.▶ Gjithsej, studenti ka 1000 pikë të disponueshme, nga të cilat:<ul style="list-style-type: none">• 400 pikë provimet e mesit të semestrit;• 100 pikë projektet/detyrat e kurseve;• 500 pikë provimi përfundimtar.

14. Të gjitha programet mësimore të Fakultetit të Edukimit në Universitetin e Durrësit janë të standardizuara sipas këtij kriteri vlerësimi.

<i>Edukimi për qytetari</i>	6	2013	
<i>Edukimi gjithëpërfshirës</i>	6	2013	
<i>Metodologjitë e mësimdhënies</i>	6	2013	
<i>Komunikimi me fëmijët në moshë të hershme</i>	6	2013	
<i>Etika profesionale e mësimdhënësve</i>	3	2013	
<i>Të menduarit kritik</i>	6	2012	
<i>Edukimi për qytetari dhe institucionet e BE-së</i>	5	2011	
<i>Edukimi për qytetari demokratike</i>	6	2012	
<i>Të drejtat dhe mbrojtja e fëmijëve</i>	6	2011	
<i>Edukimi special</i>	5	2011	
<i>Edukimi multikulturor</i>	6	2011	
<i>Edukimi për Qytetari Demokratike</i>	6	2012	
<i>Shkolla dhe shoqëria</i>	6	2011	
<i>Mbrojtja e fëmijëve</i>	5	2018	

8.1.1 Programe Bachelor dhe përputhshmëria me EQD-në

Mësimdhënia në arsimin parashkollor: studentët pritet të ndjekin dy kurse bazë tejet të përputhshme me EQD-në: *Edukimi për qytetari dhe Edukimi për të drejtat e fëmijëve*, të cilat janë kurse të detyrueshme që sigurojnë përgatitjen për disiplinën shkencore.¹⁵

Në kursin *Edukimi për të drejtat e fëmijëve* (6 ECTS), studentët nuk përqendrohen vetëm tek aspekti teorik i të drejtave të fëmijëve, por edhe te zbatimi i tyre. Qëllimi është që mësuesit-studentë, të njohin të drejtat e njeriut, historinë dhe institucionet (si OKB-ja, BE-ja). *Rezultatet e të nxëniet* të këtij kursi mbulojnë kuptimin e konceptit të të drejtave njerëzore dhe të drejtave të fëmijëve; rolin e institucioneve evropiane dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut; kuptimin e konceptit të edukimit qytetar për fëmijët; demonstrimin e rëndësisë së të qenit qytetar në komunitet; parimet e mira të përbashkëta etj. Përmes veprimtarive të organizuara brenda dhe jashtë kampusit, studentët njihen me të drejtat e njeriut dhe me zbatimin e tyre në një shoqëri demokratike. Kursi i pajis studentët me kompetenca profesionale, që u mundësojnë atyre t'i përfshijnë të drejtat e fëmijëve në lëndë të ndryshme dhe t'i planifikojnë të drejtat e tyre përmes një metodologjie interaktive. *Konceptet kyçe* të kursit lidhen me KDF-në dhe me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe u mundësojnë mësuesve-studentë të fitojnë kompetencat e mosdiskriminimit, zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe të krijojnë një mjedis miqësor shkollor.

15. B – Lëndë e përgjithshme e kategorizuar si përgatitje për disiplinën shkencore.

Qëllimi kryesor i kursit *Edukimi për qytetari* (6 ECTS) është formësimi dhe krijimi i personalitetit të mësuesit-student. Konceptet kyçe theksojnë rëndësinë e vlerave komunitare të tolerancës, bashkëpunimit dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve pa dhunë. *Konceptet kyçe* që duhen përfaqëuar nga studentët lidhen me kurrikulën, parimet dhe standardet e EQD-së; demokracinë dhe parimet demokratike; edukimin formal dhe joformal; programet e EQD-së për fëmijët parashkollorë etj. *Literatura e kërkuar dhe e rekomanduar* për studentët merret nga qasjet e KiE-së për edukimin, EQD-në dhe EDNJ-në. Ndonëse programi mësimor i lëndës përmend që veprimtaritë për të drejtat e fëmijëve dhe nismat e shërbimit komunitar duhet të jenë pjesë e planeve mësimore, ato vështirë se përdoren si kriterë vlerësimi që përfshijnë kryesisht provimet me shkrim.

Tri kurset e tjera, tejet të përshtatshme me *edukimin për qytetari demokratike*, janë: *Arsimi gjithëpërfshirës*, *Metodologjitë e mësimdhënies* dhe *Komunikimi me fëmijët në moshë të hershme*. Këto kurse janë të detyrueshme dhe secili prej tyre ka nga gjashtë kredite. Përmes tyre synohet që mësuesit-studentë të fitojnë kompetenca profesionale, të tilla si: mbrojtja e dinjitetit njerëzor dhe e të drejtave të njeriut, mosdiskriminimi, aftësia për të miratuar praktika gjithëpërfshirëse, promovimi i pranimit social të dallimeve, respekti për diversitetin, kuptimi dhe praktikimi i metodologjive me në qendër fëmijën. Konceptet kyçe të zhvilluara përmes këtyre kurseve përfshijnë kompetencat kyçe: respektimi i opinionëve të ndryshme dhe diversitetit në përgjithësi, toleranca dhe mendësia qytetare, marrja parasysh e interesit më të mirë për fëmijën dhe e mira e përbashkët.

Etika profesionale e mësimdhënësve (3 ECTS) është një kurs me zgjedhje (jo i detyrueshëm), i cili ofrohet si lëndë e integruar, ndërdisiplinore. Programi i kësaj lënde u mundëson studentëve të fitojnë kompetencat e të mësimit të pavarur, të menduarit analitik dhe kritik.

Arsimi fillor¹⁶(mësimdhënia në ciklin e ulët): *Të menduarit kritik* (6 ECTS) është kurs bazë që zhvillohet gjatë vitit të dytë dhe të tretë të studimeve dhe ka për qëllim zhvillimin e aftësive të të menduarit analitik dhe kritik të studentëve. Objektivi kryesor i kursit është përgatitja e studentëve për kompleksitetet e një shoqërie globale. Konceptet kyçe mundësojnë përfundimin e kompetencave analitike dhe kritike, aftësitë e të mësuarit të pavarur, aftësitë e përpunimit të informacionit; aftësitë e bashkëpunimit me të tjerët dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Në nivel njohurish, studentët zhvillojnë kuptimin kritik dhe njohuritë e tyre.

Metodologjitë e mësimdhënies (6 ECTS) është një kurs i projektuar për zbatimin e teorisë në praktikë. Kursi mbulon mësimdhënien në klasë, metodologjitë e mësimdhënies dhe vlerësimin. Programi i koncepteve kyçe u mundëson mësuesve-studentë të përftojnë kompetenca profesionale në mësimdhënie, në menaxhimin e klasës/mësimit, identifikimin e praktikave që maksimizojnë potencialin e nxënësit, si dhe të zhvillojnë strategji për maksimizimin e të nxënët etj. I gjithë kursi përshkohet nga qasja e metodologjisë bashkëkohore të mësimdhënies, që e vendos nxënësin në qendër të procesit të mësimit dhe i kthen ata në protagonistë, duke kontribuar kështu në zbatimin e EQD-së/EDNJ-së në shkollë.

16. Dy kurset – *Edukimi për qytetari* dhe *Edukimi për të drejtat e fëmijëve*, që janë pjesë e programit Bachelor për mësimdhënie në arsimin parashkollor, nuk përfshihen në nivelin e ciklit të ulët.

Edukimi gjithëpërfshirës (6 ECTS) është kurs i detyrueshëm. Programi i kësaj lënde u mundëson studentëve të zhvillojnë kompetencat kyçe të të qenit të hapur ndaj diversitetit, tolerancës dhe mendësisë qytetare, duke marrë parasysh interesin më të mirë të fëmijës dhe të mirën e përbashkët. Kursi fokusohet te të kuptuarit të nevojave dhe të drejtave të fëmijëve me nevoja të posaçme, te strategjitë e përfshirjes, bashkëpunimi me aktorët e tjerë të shkollës dhe komunitetit, roli i institucioneve etj.

Ekspert në proceset e formimit: *Edukimi për qytetari dhe institucionet e BE-së* (5 ECTS) është kurs i detyrueshëm, që zhvillohet gjatë vitit të parë të studimeve. Objektivat e kursit përfshijnë familjarizimin e studentëve me konceptet *qytetar* dhe *qytetari*, qytetari evropian, demokracia dhe shteti i së drejtës dhe institucionet e BE-së. Konceptet kyçe lidhen me diversitetin kulturor, të drejtat e njeriut, edukimin për të drejtat e njeriut, përmbajtjen politike dhe historike të institucioneve të BE-së, të drejtat politike, sociale dhe ekonomike etj. Metodatat e vlerësimit të kursit përfshijnë provimet dhe programi mësimor i kursit nuk përqendrohet te veprimtaritë joformale ose tek ato praktike.

Kurset e tjera të ofruara në nivel Bachelor, si mësues i gjuhëve të huaja, përfshijnë *Metodologjitë e mësimdhënies* (6 ECTS) si disiplinën mbizotëruese për EQD-në, e cila përfshihet në të gjitha vitet e studimeve.

8.1.2 Programet master dhe përputhshmëria me standardet e EQD-së

Studentët vazhdojnë të fitojnë njohuri mbi EQD-në, edukimin për të drejtat e njeriut dhe për qytetari, përmes kurrikulës spirale në programet studimore të ciklit të dytë, master.

Master profesional **Arsimi bazë:** *Edukimi për qytetari demokratike* (6 ECTS) është kurs i detyrueshëm, që zhvillohet në vitin e parë, si përgatitje për disiplinën shkencore. Në 45 orë mësimore, kursi merret me konceptet bazë të edukimit për qytetari demokratike, standardet, kurrikulën, parimet dhe objektivat e EQD-së. Kursi synon të sigurojë akses dhe informacion për konceptet e qarta të EQD-së; për sfidat konceptuale të qytetarëve dhe qytetarisë në kontekstin demokratik; për analizën e EQD-së në edukimin formal, joformal dhe informal; për aftësitë, kompetencat dhe metodologjitë e kërkuara për EQD-në. *Literatura e detyrueshme dhe e rekomanduar* për studentët në këtë kurs përfshin shumë materiale burimore të KiE-së. Vlerësimi bëhet përmes provimeve dhe nuk realizohet, posaçërisht, në nivel të praktikave/veprimtarive.

Metodologjitë e mësimdhënies dhe Të menduarit kritik janë dy kurse të tjera të detyrueshme (secila me nga 6 ECTS). Mësuesit-studentë përfitojnë kompetencat kyçe të aftësive të të menduarit kritik dhe analitik, aftësitë e të mësuarit të pavarur, aftësitë e përpunimit të informacionit, bashkëpunimit me të tjerët dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Përmes këtyre kurseve, ata ushtrojnë kompetencën e metodologjive të mësimdhënies me në qendër fëmijët, si kusht paraprak për zbatimin e EQD-së.

Master profesional **Psikologjia shkollore dhe zhvillimore:** *Të drejtat dhe mbrojtja e fëmijëve* (5 ECTS) jepet si kurs ndërdisiplinor me zgjedhje, së bashku me një tjetër. Kursi përqendrohet në: konceptet e të drejtave të fëmijëve, e drejta e mbrojtjes nga abuzimi, standardet për mbrojtjen e fëmijëve në shkollë; zgjidhja e problemeve të fëmijëve etj. Ai synon të ndihmojë studentët që të kuptojnë mbrojtjen e fëmijëve, të kontribuojnë në krijimin e një sistemi mbrojtjeje efektive për fëmijët në shkollë, të krijojnë aftësi dhe kompetenca për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe të reflektojnë

mbi praktikat që mund t'i vënë në rrezik të drejtat e fëmijëve. *Literatura e kërkuar dhe e rekomanduar* përfshin instrumentet e të drejtave të njeriut dhe materiale nga organizata ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Kursi *Edukimi special* (5 ECTS) ka për qëllim fuqizimin e mësuesve-studentë me elemente të pedagogjisë speciale, në mënyrë që të rrisë ndërgjegjësimin mbi shkaqet, faktorët, ndërhyrjen dhe rehabilitimin e fëmijëve me nevoja të veçanta. Kompetencat kyçe të përftuara, janë: edukimi gjithëpërfshirës, respekti për qenien njerëzore dhe dinjitetin.

Masteri profesional **Didaktika: Të menduarit kritik** (6 ECTS) është lëndë kyçe në përputhshmëri të lartë me EQD-në, si dhe përfshihet te kurset e detyrueshme. *Edukimi multikulturor* dhe *Edukimi për qytetari demokratike* (6 ECTS) janë lëndë të integruara dhe ndërkulturore¹⁷ dhe ofrohen si kurse me zgjedhje (studentët mund të zgjedhin mes tyre). Gjithashtu, janë edhe dy kurse të tjera: *Edukimi special* dhe *Shkolla dhe shoqëria* (6 ECTS) në përputhje të plotë me edukimin për qytetari demokratike.

Master shkencor **Administrimi dhe mbikëqyrja e institucioneve arsimore: Mësimi gjatë gjithë jetës** (6 ECTS) dhe *Shkolla dhe shoqëria* janë kurse me zgjedhje. Studentët mund të zgjedhin t'i ndjekin këto kurse, pasi ato përmbushin fushën e tyre të studimit. Të dyja kurset janë në përputhje me parimet e EQD-së. Ato synojnë të forcojnë qeverisjen e shkollës me pjesëmarrjen komunitare. Gjatë këtyre kurseve, studentët zhvillojnë kompetencat e bashkëpunimit mes shkollës dhe komunitetit, si dhe të përfshirjes në to, vendimmarrjen e bazuar në dije; vendimmarrjen në bazë të strategjive për përfshirje dhe zhvillimin e shkollave si qendra komunitare.

Master shkencor **Psikologji dhe sociologji: Mbrojtja e fëmijëve** (5 ECTS) është kurs me zgjedhje. Përmbajtja e kursit bazohet në të drejtat e njeriut dhe në të drejtat e fëmijëve, duke u përqendruar veçanërisht tek e drejta e mbrojtjes nga abuzimi. Ky kurs u mundëson mësuesve-studentë të aftësohen në trajtimin e rasteve të abuzimit me fëmijët/nxënësit, por edhe me fëmijët e tjerë.

8.2 UNIVERSITETI “ALEKSANDËR XHUVANI”, ELBASANT

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” njihet për historinë e tij të gjatë në edukimin e mësimdhënësve. Qysh prej vitit 1909 e deri në ditët e sotme, ky universitet ka përgatitur mësues për arsimin fillor dhe atë të mesëm në Shqipëri dhe në të gjitha vendet shqipfolëse në Ballkan. Historikisht, mësuesi ka qenë figura qendrore e këtij qyteti, që gëzonte respekt nga komuniteti dhe të ardhura financiare të mira.

Fakulteti i Edukimit në këtë Universitet përbëhet nga departamentet e mëposhtme:

- ▶ Departamenti i Edukimit për Qytetari,
- ▶ Departamenti i Metodologjive të Mësimdhënies,
- ▶ Departamenti i Psikologjisë,
- ▶ Departamenti i Shkencave Sociale,
- ▶ Departamenti i Sporteve dhe Edukimit Fizik,
- ▶ Qendra për Kërkim dhe Zhvillim.

17. Lloji C: ndërdisiplinor, lëndë me zgjedhje.

Kurset e analizuara:

Emri i kursit	ECTS	Viti i fillimit	Lloji i vlerësimit
<i>Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut</i>	5	2010	<ul style="list-style-type: none"> ▶ 75% për frekuentimin, ▶ 25% për provimin/testin e messemestrit, ▶ Provimi përfundimtar realizohet me gojë dhe me shkrim, në bazë të tematikës së kursit.
<i>Demokracia me pjesëmarrje</i>	4	2013	<ul style="list-style-type: none"> ▶ 75% për frekuentimin, ▶ 25% për provimin/testin e messemestrit, ▶ Provimi përfundimtar realizohet me gojë dhe me shkrim, në bazë të tematikës së kursit.
<i>Didaktika e edukimit për qytetari dhe vlerësimi</i>	4,5	2016	<ul style="list-style-type: none"> ▶ 60% për frekuentimin, ▶ 20% për kontrollin e messemestrit, ▶ 10% projektet dhe veprimtaritë nga studentët, ▶ 10% provimi përfundimtar.
<i>Sistemet e qeverisjes</i>	6	2006	<ul style="list-style-type: none"> ▶ 25% pjesëmarrja në leksione dhe në seminare, dorëzimi i projekteve dhe i detyrave, pjesëmarrja në praktikë dhe në laborator, ▶ 25% për provimin e messemestrit, ▶ 50% provimi përfundimtar.
<i>Globalizimi dhe identiteti</i>	5	2016	<ul style="list-style-type: none"> ▶ 40% pjesëmarrja në leksione dhe në seminare, ▶ 20% dorëzimi i detyrave të kursit dhe i projekteve, ▶ 40% vlerësimi i provimit përfundimtar.
<i>Edukimi gjithëpërfshirës</i>	8	2016	<ul style="list-style-type: none"> ▶ 50% pjesëmarrja në leksione dhe në seminare, ▶ 50% dorëzimi i projekteve dhe i detyrave; pjesëmarrja në praktikë dhe në laborator.
<i>Kurrikula dhe metodologjitë e mësimdhënies</i>	7	Qysh prej themelimit të Fakultetit, por përditësohet nga pedagogët përkatës me prirje të reja teorike.	<ul style="list-style-type: none"> ▶ 20% pjesëmarrja në leksione dhe në seminare, ▶ 20% dorëzimi i detyrave të kursit dhe i projekteve, ▶ 10% pjesëmarrja në praktikë dhe në laborator, ▶ 50% vlerësimi i provimit përfundimtar.

<i>Mësimi përmes lojërave</i>	4	2010	<ul style="list-style-type: none"> ▶ 20 % pjesëmarrja në leksione dhe në seminare, ▶ 20% dorëzimi i detyrave të kursit dhe i projekteve, ▶ 20 % pjesëmarrja në praktikë dhe në laborator, ▶ 40% vlerësimi i provimit përfundimtar.
<i>Njohuritë mbi shoqërinë</i>	5	2015	<ul style="list-style-type: none"> ▶ 40% pjesëmarrja në leksione dhe në seminare, ▶ 20% dorëzimi i detyrave të kursit dhe i projekteve, ▶ 40% vlerësimi i provimit përfundimtar.
<i>Edukimi për qytetari dhe didaktika</i>	4	2016	<ul style="list-style-type: none"> ▶ 20% pjesëmarrja në leksione dhe në seminare, ▶ 20% dorëzimi i detyrave të kursit dhe i projekteve, ▶ 20% pjesëmarrja në praktikë dhe në laborator, ▶ 40% vlerësimi i provimit përfundimtar.
<i>Metodologjitë e mësimdhënies përmes teknologjive të reja</i>	6	2012	<ul style="list-style-type: none"> ▶ 10% pjesëmarrja në leksione dhe në seminare, ▶ 25% dorëzimi i detyrave të kursit dhe i projekteve, ▶ 25% pjesëmarrja në praktikë dhe në laborator, ▶ 40% vlerësimi i provimit përfundimtar.
<i>Edukimi për sipërmarrjen</i>	3	2016	<ul style="list-style-type: none"> ▶ 10% pjesëmarrja në leksione dhe në seminare, ▶ 25% dorëzimi i detyrave të kursit dhe i projekteve, ▶ 25% pjesëmarrja në praktikë dhe në laborator, ▶ 40% vlerësimi i provimit përfundimtar.
<i>Të drejtat e fëmijëve dhe etika profesionale</i>	6	2018	<ul style="list-style-type: none"> ▶ 30% pjesëmarrja në leksione dhe në seminare, ▶ 10% dorëzimi i projekteve dhe i detyrave, ▶ 10% pjesëmarrja në praktikë dhe në laborator, ▶ 10% për provimin e messemestrit, ▶ 40% provimi përfundimtar.

<i>Përfshirja në edukimin e hershëm</i>	8	2018	<ul style="list-style-type: none"> ▶ 20% është pjesëmarrja në leksione dhe në seminare, ▶ 20% dorëzimi i detyrave të kursit dhe i projekteve, ▶ 20% pjesëmarrja në praktikë dhe në laborator, ▶ 40% vlerësimi i provimit përfundimtar.
<i>Diversiteti kulturor</i>	5	2012	<ul style="list-style-type: none"> ▶ 30% pjesëmarrja në leksione dhe në seminare, ▶ 15% dorëzimi i projekteve dhe i detyrave, ▶ 15% pjesëmarrja në praktikë dhe në laborator, ▶ 40% provimi përfundimtar.
<i>Orientimi dhe edukimi për karrierën</i>	4	2012	<ul style="list-style-type: none"> ▶ 75% për frekuentimin, ▶ 25% për provimin final dhe mes sezonit. ▶ Provimi përfundimtar realizohet me gojë dhe me shkrim dhe përmban dhjetë pyetje të bazuara në tematikat e lëndës.
<i>Etika profesionale e mësimdhënësve</i>	4	Qysh prej themelimit të Fakultetit dhe i është nënshtruar përditë-simeve të vogla kurrikulare	<ul style="list-style-type: none"> ▶ 70% pjesëmarrja në leksione dhe në seminare, ▶ 30% për provimin/ testin përfundimtar.
<i>Logjika dhe të menduarit kritik</i>	7	2008	<ul style="list-style-type: none"> ▶ 30% pjesëmarrja në leksione dhe në seminare, ▶ 30% dorëzimi i detyrave të kursit dhe i projekteve; pjesëmarrja në praktikë dhe në laborator, ▶ 40% vlerësimi i provimit përfundimtar.
<i>Shkolla dhe shoqëria</i>	5	2016	<ul style="list-style-type: none"> ▶ 40% pjesëmarrja në leksione dhe në seminare, ▶ 20% dorëzimi i detyrave të kursit dhe i projekteve, ▶ 40% vlerësimi i provimit përfundimtar.

8.2.1 Programet *Bachelor* në përputhshmëri me EQD-në

Departamenti i Edukimit Qytetar është aktualisht i vetmi departament në Shqipëri që i kushtohet EQD-së dhe ofron programet e mëposhtme:

- ▶ *Bachelor* në Edukimin për qytetari,
- ▶ *Bachelor* në Filozofi-sociologji.

Ky departament nuk ofron programe *master* të dedikuar e megjithëkëtë shumë prej lëndëve jepen në *master profesional*, të specializuar në shkencat humane dhe sociale.

(*Bachelor*) **Edukimi për qytetari**¹⁸ është një program studimi që synon t'u japë studentëve trajnimin bazë për qytetarinë demokratike dhe t'i pajisë ato me njohuri më të thelluara mbi tema, të tilla si: politika, morali, feja, edukimi etj. Programi përqendrohet te lëndët e qytetarisë, edukimit shoqëror dhe në lëndë të tjera, si: historia, gjeografia, këshillimi për karrierën, financa etj. Ky program (që ka nisur në vitin 1998) është konsoliduar me kalimin e viteve dhe mbetet programi i parë i edukimit për qytetari në nivel universitar në Shqipëri dhe në rajon. Studentët, që ndjekin këtë program *Bachelor*, zhvillojnë aftësi intelektuale për të shpjeguar dhe për të trajtuar dukuritë sociale, problemet e përditshme në shtëpi, shkollë dhe shoqëri; për të shkruar përtej gjendjes empirike të fakteve, për të menduar në mënyrë kritike dhe kreative, si dhe për të treguar mendësi të hapur ndaj çështjeve politike, morale, fetare dhe jetësore. Vlerat e promovuara janë ato që kontribuojnë në pjesëmarrjen sociale e politike, si dhe sipërmarrjen sociale.

Të drejtat dhe liritë e njeriut (5 ECTS) zhvillohet si kurs bazë për përgatitjen profesionale, kulturore dhe metodologjike të studentëve. *Konceptet kyçe* trajtojnë të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sistemet e qeverisjes. Në nivel dijesh, studentët marrin njohuri për konceptet, kategoritë e të drejtave të njeriut, dokumentet ndërkombëtare, historinë, institucionet ndërkombëtare, që mbrojnë të drejtat e njeriut dhe praktikën e zbatimit të të drejtave të njeriut. Gjithashtu, kursi përqendrohet fort te trajnimi profesional i studentëve sa i përket identifikimit dhe përdorimit të metodave bashkëkohore të edukimit për të drejtat e njeriut. Literatura e rekomanduar për këtë kurs përfshin të paktën tri botime kryesore nga bibliografia e KiE-së për të drejtat e njeriut dhe edukimin për qytetari.

Demokracia pjesëmarrëse (4 ECTS) është kurs i detyrueshëm e tepër i rëndësishëm për përgatitjen kulturore dhe metodologjike. *Konceptet kyçe* janë: demokracia, të drejtat e njeriut dhe pjesëmarrja në vendimarrje. Qëllimi i tij kryesor është pajisja e studentëve me njohuri dhe aftësi për ta njohur demokracinë si sistemin dominues të qeverisjes në botën bashkëkohore, si dhe rolin e ndikimit e saj të thellë në jetën e të gjithë qytetarëve. *Kompetencat kyçe*, të përfuara gjatë këtij kursi, lidhen me pranimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, pluralizmin politik, pjesëmarrjen qytetare në vendimarrjen politike, modelet edhe llojet e perceptimeve bashkëkohore të demokracisë dhe demokracinë si koncept politik dhe qeverisës.

18. Vendosja e notës mesatare 7.5, si kriter pranimi në universitet, ka ulur ndjeshëm numrin e studentëve që studiojnë "Mësimdhënie" në Elbasan. Përcaktimi i notës mesatare hyrëse, veçanërisht për Departamentin e Edukimit për Qytetari, ka sjellë që të mos regjistrohet pothuajse ASNJË student në programet përkatëse.

Didaktika e edukimit qytetar dhe vlerësimi (4.5 ECTS) është një tjetër kurs i detyrueshëm që ofrohet në vitin e parë akademik. Programi lëndor mbulon konceptet, qëndrimet dhe sfidat e qytetarëve dhe qytetarisë, të cilat janë themelore për *kompetencat kyçe të EQD-së*: kultura qytetare në kontekstin demokratik. Kursi ngre argumente mbi edukimin ndërkulturor, edukimin për paqen dhe edukimin global, si çështje shumë të rëndësishme në lidhje me qytetarinë demokratike. Temat kryesore shpjegojnë konceptet e edukimit formal e atij joformal, të edukimit të të rriturve, si dhe kurrikulën dhe kompetencat e aktorëve kryesorë të *edukimit për qytetari demokratike*.

Sistemet e qeverisjes (6 ECTS) është një tjetër kurs i detyrueshëm në nivelin *Bachelor*. Kursi përqendrohet te të kuptuarit e koncepteve të politikës dhe të rolit të saj në zhvillimin e shoqërisë; të konceptit të qeverisjes; të klasifikimit dhe të efikasitetit të qeverisjes; të demokracisë liberale; të sistemeve të qeverisjes nga pikëpamja historike.

Globalizimi dhe identiteti (5 ECTS) u mundëson studentëve të zhvillojnë konceptet kyçe, si: identiteti kulturor, globalizimi dhe kontekstet lokale.

Pothuajse të GJITHA lëndët e Edukimit për qytetari janë pjesë e kurrikulës së ciklit të dytë të studimeve, master profesional, që zhvillohen nga Departamenti i Metodologjive të Mësimdhënies.

Departamenti i Metodologjive të Mësimdhënies ofron programet e mëposhtme:

- ▶ Bachelor në Arsimin parashkollor,
- ▶ Bachelor në Arsimin fillor,
- ▶ Diplomë profesionale për “Mësues për fëmijë nga 0-3 vjeç”,
- ▶ Master shkencor për “Mësues për arsimin fillor”,
- ▶ Mastera profesionale për mësues në lëndë të ndryshme, si: fizikë, informatikë, biologji, letërsi, gjuhë të huaja, histori, gjeografi, edukimi për qytetari, udhëheqje në arsim.

Të gjithë masterat profesionale në mësimdhënie kanë të njëjtën strukturë, në lidhje me orët mësimore, kreditet, orët në klasë, praktikat mësimore dhe studimet individuale. Dallimet mes tyre qëndrojnë te lëndët që e trajtojnë trajnimin akademik si kompetencë shtesë dhe te kurset me zgjedhje.

Nuk ka programe të ciklit të tretë të studimit, studime doktorale.

(Bachelor) Arsimi parashkollor synon t’i pajisë studentët me njohuritë dhe kompetencat kyçe për përgatitjen dhe trajnimin e tyre si mësues të ardhshëm për fëmijët në moshë parashkollore. Analizimi i detajuar i kurrikulës së shkruar tregon se ekzistojnë të paktën katër kurse tejet të përputhshme me EQD-në, që janë: *Edukimi gjithëpërfshirës, Kurrikula dhe metodologjitë e mësimdhënies, Mësimi përmes lojërave dhe Njohuri për shoqërinë*.

Edukimi gjithëpërfshirës (8 ECTS) u mundëson mësuesve-studentë të krijojnë kompetencat bazë të tolerancës dhe të qytetarisë, të përfshirjes dhe mosdiskriminimit. Kursi përqendrohet në të kuptuarit e nevojave dhe e të drejtave të fëmijëve me nevoja të posaçme, te strategjitë e përfshirjes, bashkëpunimi me aktorët e tjerë të shkollës dhe të komunitetit, roli i institucioneve etj. Kursi përqendrohet, gjithashtu, tek identifikimi i hershëm i aftësive të kufizuara dhe i praktikave gjithëpërfshirëse për fëmijët parashkollorë.

Kurrikula dhe metodologjitë e mësimdhënies (7 ECTS) u mundëson studentëve të informohen rreth përmbajtjes dhe hartimit të kurrikulës, parimeve bazë dhe qasjeve me në qendër fëmijët. Kursi përqendrohet kryesisht te pedagogjia dhe përshtatja e teknikave efektive për të maksimizuar mësimdhënien dhe të nxënit përmes praktikave interaktive.

Mësimi përmes lojërave (4 ECST) i kushton vëmendje të konsiderueshme të drejtave të fëmijëve dhe së drejtës për të luajtur. Përmes këtij kursi, mësuesit-studentë fitojnë njohuri rreth fazave zhvillimore të fëmijëve dhe rreth teknikave të lojërave të përshtatshme për moshën e tyre.

Njohuri për shoqërinë (5 ECTS) është një tjetër kurs i detyrueshëm, që u mundëson mësuesve-studentë të marrin informacione mbi fenë, kulturën dhe nënkulturat; normat dhe stereotipat socialë, trajtat e shoqërive urbane dhe rurale, sfidat e familjes moderne etj. Kursi i ndihmon studentët të krijojnë kompetenca lokale dhe globale.

(Bachelor) Arsimi fillor synon t'u japë studentëve njohuri të thella, që të zhvillojnë kompetenca kyçe për trajnimin e tyre si mësues nga klasa I deri në V. Sipas kurrikulës së shkruar, ekzistojnë të paktën katër kurse tejet të përputhshme me standardet e EQD-së, të cilat janë: *Edukimi për qytetari dhe didaktika, Metodologjitë e mësimdhënies përmes teknologjive të reja, Mësimi përmes lojërave dhe Edukimi për sipërmarrjen.*

Edukimi për qytetari dhe didaktika (4 ECTS) është kurs i detyrueshëm. Ai trajton konceptet, qëndrimet dhe sfidat e qytetarëve dhe qytetarisë, të cilat janë themelore për *kompetencat kryesore të EQD-së* dhe që lidhen me kulturën qytetare në kontekstin demokratik. Kursi ngre argumente mbi edukimin ndërkulturor, edukimin për paqen dhe edukimin global si çështje shumë të rëndësishme sa i përket qytetarisë demokratike. Temat kryesore shpjegojnë konceptet e edukimit formal, edukimit joformal dhe edukimit të të rriturve, si dhe kurrikulën dhe kompetencat e aktorëve kryesorë të EQD-së. Kursi përqendrohet kryesisht tek ofrimi i instrumenteve/prezantimi i modeleve për zbatimin efektiv të standardeve të EQD-së në shkolla, veçanërisht në arsimin fillor.

Metodologjitë e mësimdhënies përmes teknologjive të reja (6 ECTS) është kurs i detyrueshëm, qëllimi kryesor i të cilit është zhvillimi i kompetencave për mësimdhënien me në qendër fëmijën, si kusht paraprak për zbatimin e EQD-së dhe zhvillimin e aftësive për shpjegimin efektiv të EQD-së në klasë.

Mësimi përmes lojërave (4 ECST) i jep përparësi të drejtave të fëmijëve dhe së drejtës për të luajtur. Përmes këtij kursi, mësuesit-studentë fitojnë njohuri rreth fazave zhvillimore të fëmijëve dhe rreth teknikave të lojërave të përshtatshme për moshën e tyre. Fokusi është te fëmijët e moshës 6–12-vjeçare.

Edukimi për sipërmarrjen (3 ECTS) është kurs bashkëkohor me zgjedhje që bazohet te rëndësia e sipërmarrjes dhe e vullnetarizmit të mësuesve. Kursi zhvillon kompetencat e transformimit të ideve në veprime përmes kreativitetit, risive, analizës, planifikimit të projekteve, aftësive menaxhuese etj.

Programe studimi me karakter profesional – edukator 0–3 vjeç është një program dyvjeçar që ofrohet nga Departamenti i Metodologjive të Mësimdhënies.

Të drejtat e fëmijëve dhe etika profesionale (6 ECTS) është kurs i detyrueshëm, i ofruar gjatë vitit të dytë (në të dy semestrat). Përgjatë këtij kursi, studentët fitojnë njohuri mbi të drejtat e fëmijëve dhe institucionet përkatëse përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve në nivel kombëtar, rajonal dhe global. Kursi ofron ekspertizë profesionale në identifikimin dhe përdorimin e metodave bashkëkohore, që garantojnë zbatimin e të drejtave të fëmijëve, siç janë qasjet e edukimit të bazuara te të drejtat e njeriut. Kompetencat kyçe të përftuara, janë: të drejtat e fëmijëve, etika profesionale dhe demokracia.

Të drejtat e fëmijëve dhe etika profesionale jepet, gjithashtu, edhe në të gjithë masterat profesionalë në mësimdhënie gjatë semestrit të parë dhe atij të dytë. Gjatë orëve të semestrit të parë bëhet një përmbledhje e përgjithshme e të drejtave të fëmijëve, e parimeve të mosdiskriminimit, e pjesëmarrjes dhe mbrojtjes, e interesit më të mirë për fëmijët, e metodologjive për mësimdhënien e të drejtave të fëmijëve etj. Ndërsa semestri i dytë përqendrohet te përmirësimi i ekspertizës profesionale dhe rritja e ndërgjegjësimit për misionin e mësuesve të ardhshëm përmes kompetencave kyçe për etikën e mësuesit, diversitetin e vlerave, përfshirjen e fëmijëve dhe të komunitetit (arsimi gjithëpërfshirës).

Gjithëpërfshirja në edukimin e hershëm (8 ECTS) është kurs i detyrueshëm që zhvillohet përgjatë gjithë vitit, në të dy semestrat, dhe ofron njohuri mbi edukimin gjithëpërfshirës në përgjithësi dhe edukimin special në veçanti. Kompetencat kyçe të zhvilluara në këtë lëndë, janë: diversiteti, edukimi gjithëpërfshirës, vlerësimi, planet e veprimt për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të posaçme dhe konceptet/llojet e aftësisë së kufizuar. Moduli i parë fokusohet te kuadri ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar, diversiteti i fëmijëve, specifikat mjedisore që ndikojnë në rritjen e fëmijëve, te vëzhgimi, monitorimi, analiza dhe vlerësimi i mjedisit mësimor, njohuritë mbi teknikat e ndërhyrjes. Moduli i dytë mbulon njohuritë mbi llojet e aftësive të kufizuara, përkufizimin e tyre, shkaqet, faktorët, klasifikimin e aftësive të kufizuara, si dhe ndikimi i arsimit, strategjitë dhe veprimet për çdo kategori. Objektivi kryesor i të gjithë kursit është ndërgjegjësimi i studentëve rreth rëndësisë së edukimit gjithëpërfshirës dhe përfitimet e këtij arsimimi, që shkojnë në dobi të fëmijëve, familjeve të tyre dhe komunitetit të gjerë. Kompetenca kyçe, e zhvilluar përgjatë kursit, është aftësia ndërkulturore për të inkurajuar procesin e identifikimit të nevojave të fëmijëve në kontekstin e familjes, racës dhe diversitetit kulturor.

8.2.2 Programet master në përputhshmëri me standardet e EQD-së

Masteri profesional në **Mësuesi** u mundëson studentëve të zhvillojnë kompetencat dhe aftësitë e nevojshme për të praktikuar në mënyrë efektive profesionin e mësimdhënies përmes lëndëve të ndryshme dhe në mjedise të ndryshme socio-kulturore. Programi ka për qëllim t'i fuqizojë studentët të mendojnë në mënyrë kritike, si dhe të gjejnë zgjidhje shkencore për pengesa/probleme të mundshme në lidhje me arsimimin, të analizojnë aftësitë e nxënies së nxënësve, të reflektojnë dhe të vlerësojnë në mënyrë kritike kurrikulën e shkollës/kursit që ajo të përshtatet me një grup të larmishëm nxënësish, të krijojnë praktika të mira, të rrisin vlerat dhe të zhvillojnë një vizion strategjik për mësimdhënien dhe të nxënit. Programi përmban vlera evropiane dhe rrit njohuritë mbi arsimimin dhe didaktikën, duke u përqendruar te kërkimi shkencor. Përveç aftësive teknike, të lidhura me metodologjitë arsimore,

komunikimin dhe çështjet e zhvillimit të fëmijëve, programi i kushton vëmendje të posaçme formësimit të mësuesve të ardhshëm, duke rritur vlerat e tyre etike dhe demokratike, duke mbrojtur, promovuar dhe zbatuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe duke promovuar paqen, lirinë dhe barazinë.

Numri i masterave profesionalë është shumë i madh,¹⁹ ndaj dhe do të ishte i pamundur analizimi i hollësishëm i secilit prej tyre. Ajo çfarë vlen të shënohet është se **të gjithë masterat profesionalë kanë të paktën një lëndë/kurs tejet të përputhshëm me standardet e edukimit për qytetari demokratike.**

Masteri shkencor **Arsimi fillor** është i vetmi program masteri shkencor që ofrohet nga Departamenti i Metodologjive të Mësimdhënies. Krahasuar me masterat profesionalë, programet e masterit shkencor i japin përparësi analizës dhe kërkimit shkencor. *Nga këndvështrimi i përbërësve të EQD-së, përmbajtja është pothuajse e njëjtë me një prirje drejt një qasjeje më shkencore edukimi.*

Objektivi kryesor i programit është përgatitja e duhur e mësuesve të arsimit fillor, pajisja e tyre me njohuri, aftësi dhe kompetenca bashkëkohore për planifikimin, drejtimin dhe administrimin e procesit të mësimin në shkollë, duke dhënë kështu kontributin e tyre si qytetarë aktivë. Boshtet tematike të programit kanë për qëllim përgatitjen e profesionistëve të arsimit fillor që të jenë kulturalisht kompetentë e të aftë për të zgjidhur probleme në mënyrë kreative, të komunikojnë mirë dhe të mendojnë në mënyrë kritike. Programi shtjellon konceptet bazë të fushave, si: pedagogjia, psikologjia, edukimi gjithëpërfshirës, shkrimi akademik, vlerësimi dhe aspektet ligjore të arsimimit.

Diversiteti multikulturor (5 ECTS) është kurs i detyrueshëm që ofrohet në semestrin e parë të vitit të parë. Ai zhvillon dy kompetenca kryesore: *diversitetin dhe multikulturalizmin*. Mësuesit-studentë fitojnë njohuri të thella mbi edukimin multikulturor; ata përftojnë aftësi për të kuptuar dhe për të trajtuar situata të ndryshme, për të identifikuar diversitetin, për të kuptuar kulturën dhe mënyrën e ndikimit të diversitetit tek ajo; për të kuptuar diversitetin në kontekste të ndryshme, si: familja, shkolla, komuniteti. Studentët fitojnë edhe njohuri të tjera të nevojshme për zhvillimin e metodologjive të duhura të mësimdhënies, për trajtimin e strukturave të padrejta sociale. I gjithë kursi qendërohet në çështje praktike dhe raste studimore me qëllim zbatimin e teorisë në praktikë.

Orientimi dhe edukimi për karrierën (4 ECTS) është kurs i detyrueshëm që ofrohet në semestrin e dytë dhe përputhet me parimet e edukimit për qytetari demokratike. Qëllimi kryesor i tij është t'i pajisë studentët me aftësitë dhe njohuritë që iu duhen për të marrë vendime të mirinformuara, duke pasur parasysh interesin më të mirë të zhvillimit të tyre profesional. Kompetencat bazë që përftohen janë: puna në grup, të menduarit kritik, sipërmarrja dhe pjesëmarrja. Përveç aftësive të planifikimit të karrierës, analizimit ligjor për zhvillimin e karrierës, zhvillimit të kurrikulës efektive me lëndë të ndryshme, kursi përqendrohet edhe te përfshirja e prindërve dhe e komunitetit në edukimin për karrierën.

19. Janë së paku dymbëdhjetë programe studimi në drejtimin *master profesional*.

Kurse të tjera, të përputhshme me standardet e EQD-së, janë: *Etika profesionale për mësuesit* (4 ECTS), *Siguria dhe higjiena personale* (5 ECST), *Logjika dhe të menduarit kritik* (7 ECST) dhe *Shkolla dhe shoqëria* (5 ECST).

8.3 UNIVERSITETI I TIRANËS

Universiteti i Tiranës është universiteti më i madh publik në Shqipëri. Ai u themelua në vitin 1957 dhe përfshin gjashtë fakultete, dy institute dhe 174 programe studimore në tri cikle. Fakulteti i Shkencave Sociale, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja dhe Fakulteti i Shkencave Natyrore ofrojnë programet e mëposhtme:

- ▶ Mësuesi në Gjeografi, Gjuhë-letërsi dhe Histori;
- ▶ Mësuesi në Gjuhë të huaja të ndryshme,
- ▶ Mësuesi në Shkenca natyrore dhe Shkenca sociale,
- ▶ Master profesional dhe master shkencor në fusha të lidhura arsimore.

Në bazë të metodologjisë së studimit, përparësia iu është dhënë programeve që kanë më shumë përputhje me standardet e edukimit për qytetarinë demokratike dhe edukimit për të drejtat e njeriut. Në këtë kontekst, jemi përqendruar tek ato fakultete që e përmbushin këtë kriter; dhe ato janë dy: Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, të cilët përgatisin mësues për arsimin e mesëm.

Kurset e analizuar:

Emri i kursit	ECTS	Viti i fillimit	Lloji i vlerësimit ¹⁴
<i>Kurrikula e shkollës</i>	5	2006	<ul style="list-style-type: none"> ▶ 10% pjesëmarrja e detyrueshme në leksione dhe në seminare, ▶ 15% projektet individuale, ▶ 15% detyrat në grup, ▶ 20% provimi i messemestrit, ▶ 40% provimi i detyrueshëm përfundimtar.
<i>Mësimdhënia dhe të nxënit</i>	7	2006	<ul style="list-style-type: none"> ▶ 10% pjesëmarrja e detyrueshme në leksione dhe në seminare, ▶ 10% pjesëmarrja aktive në seminare, ▶ 20% përmbushja e detyrave të ndryshme, ▶ 10% detyrat individuale të kursit, ▶ 50% provimi i detyrueshëm përfundimtar.
<i>Vlerësimi i studentit</i>	5	2006	<ul style="list-style-type: none"> ▶ 15% pjesëmarrja aktive në klasë, ▶ 25% detyrat individuale të kursit, ▶ 60% provimi i detyrueshëm përfundimtar.

<i>Sociologjia e kulturës dhe moderniteti</i>	3	2006	<ul style="list-style-type: none"> ▶ 10% pjesëmarrja në klasë, ▶ 20% detyrat individuale të kursit, ▶ 20% orët e konsultimit me pedagogun dhe detyrat në grup, ▶ 50% provimi i detyrueshëm përfundimtar.
<i>Edukimi për demokraci</i>	5	2006	<ul style="list-style-type: none"> ▶ 10% pjesëmarrja në klasë, ▶ 20% detyra individuale e kursit, ▶ 20% orët e konsultimit me pedagogun dhe detyrat në grup, ▶ 50% provimi i detyrueshëm përfundimtar.
<i>Pjesëmarrja qytetare</i>	5	2006	<ul style="list-style-type: none"> ▶ 25% pjesëmarrja në klasë, ▶ 25% detyra individuale e kursit, ▶ 50% provimi i detyrueshëm përfundimtar.
<i>Edukimi multikulturor, Teoritë moderne të edukimit, Modelet e mësimdhënies, Teoritë e të nxënësve, Kurrikula e shkollës dhe Organizimi i shkollës</i>	nuk ka	2006	nuk ka
<i>Filozofia e integritimit evropian, Filozofia e së drejtës, Edukimi për demokraci, Filozofia e shtetit dhe e demokracisë, E drejta dhe shoqëria, Menaxhimi i konflikteve, Barazia gjinore, Mbrojtja e fëmijëve, Shkolla dhe shoqëria, Edukimi gjithëpërfshirës</i>	nuk ka	nuk ka	nuk ka
<i>Metodologjitë e mësimdhënies (5 ECTS), Teoritë e të nxënësve (6 ECTS), Vlerësimi i nxënësve (6 ECTS), Metodologjitë e mësimdhënies dhe të menduarit kritik (8 ECTS), Mësimdhënia dhe etika profesionale (4 ECTS)²⁰</i>		nuk ka	<ul style="list-style-type: none"> ▶ 20–25% frekuentimi i detyruar në leksione dhe në seminare, ▶ 20–25% dorëzimi i projekteve individuale dhe/ose i detyrave në grup, ▶ 50% provimet përfundimtare, esetë dhe praktika profesionale.

8.3.1 Programet *Bachelor* në përputhshmëri me EQD-në

Fakulteti i Shkencave Sociale ka një departament kushtuar *Psikologjisë dhe Pedagogjisë*, i cili ofron programe të ndryshme studimi në nivel *Bachelor* dhe *master*; por në të nuk ka programe të dedikuara *Bachelor* në mësimdhënie. Në bazë të metodologjisë së studimit, që i jep përparësi programeve studimore në mësimdhënie, u zgjedhën programet e mëposhtme:

Masteri shkencor **Mësuesi në Shkencat Sociale** ofron shumë kurse në përputhje me standardet e EQD-së.

Kurrikula e shkollës (5 ECTS) është kurs i detyrueshëm që ofrohet në semestrin e parë të vitit të parë. Mësuesit-studentë fitojnë njohuri mbi parimet, problemet dhe prirjet në zhvillimin kurrikular. Kursi ofron njohuri mbi zhvillimin e kurrikulës në kontekstin shqiptar, mbi kornizat kurrikulare, planet e mësimdhënies, tekstet shkollore, zhvillimin profesional të mësuesit, vlerësimin e kurrikulës, mbrojtjen e fëmijës dhe planifikimin e duhur të mësimin. Kompetencat kryesore të përfuara, janë: zhvillimi dhe vlerësimi i kurrikulës, edukimi multikulturor, planifikimi, të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtja e tyre.

Mësimdhënia dhe të nxënit (7 ECTS) është një tjetër kurs bazë që ofrohet në vitin e parë. Kompetencat kyçe të synuara, janë: të menduarit kritik, metodologjitë e mësimdhënies me në qendër fëmijën, planifikimi i duhur dhe përfshirja interaktive e nxënësve. Kurrikula përqendrohet te modelet e të menduarit, metodat e mësimdhënies dhe të nxënit efektiv, leximi dhe nxënia si procese ndërvepruese, arti i të dëgjuarit dhe i pyetjeve etj.

Vlerësimi i studentit (5 ECTS) ofron njohuri dhe aftësi mbi elementet e kurrikulës bazë të lidhura me klasifikimin dhe vlerësimin, vlerësimin e mësimdhënies dhe të nxënit, llojet e vlerësimit, *feedback*-un, planifikimin e vlerësimit. Vlerësimi i mësuesve-studentë mban parasysh aftësinë e tyre: për të bashkëpunuar me profesorët dhe me studentët e tjerë në klasë, për të shprehur pikëpamjet vetjake, për të menduar në mënyrë kritike, për të bërë pyetje, për të qenë dëgjues të mirë, për të shfaqur aftësi konstruktive komunikimi konstruktiv, për të dhënë kontributin e tyre në diskutime dhe debate, si dhe për ta lidhur informacionin me përvojën e tyre vetjake të mësimdhënies.

Sociologjia e kulturës dhe moderniteti (3 ECTS), kurs i planifikuar për mësuesit e shkencave sociale në nivel të mesëm, dhe u siguron studentëve kompetenca profesionale për leximin efektiv të mesazheve, mjediseve, ndërveprimeve, simboleve dhe normave të shumëfishta kulturore. Kjo lëndë i ndihmon studentët të zbërthejnë repertorin kompleks të simboleve kulturore dhe nënkulturore të shoqërisë tradicionale shqiptare, marrëdhëniet bashkëkohore me grupet etnike dhe karakteristikat kryesore të shoqërisë moderne e postmoderne. Kursi mësohet njëkohësisht me një kurs tjetër plotësues, *Sociologjia e urbanizimit, puna dhe socializimi* (2 ECTS), i cili është, po ashtu, i detyrueshëm.

Edukimi për demokraci (5 ECTS) ofrohet në vitin e dytë dhe përqendrohet te teoria e demokracisë dhe shteti i së drejtës. Konceptet kyçe të shpjeguara, janë: të drejtat

20. Këto kurse zhvillohen në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, në Universitetin e Tiranës. Të dy masterat e analizuar janë hapur në vitin 2018, ndërkohë që të gjitha kurset kanë ekzistuar më parë në këtë fakultet, por janë bërë në programe të tjera që prej procesit të Bolonjës, më 2009-n.

dhe liritë themelore të njeriut, autonomia e pushteteve në demokraci, konceptet dhe praktikat e shtetit demokratik.

Pjesëmarrja qytetare (5 ECTS) fokusohet tek edukimi për pjesëmarrje qytetare në demokraci dhe zhvillon kompetencat e aftësive të të menduarit kritik dhe rëndësinë e tyre në edukim. Kursi ka tri shtylla kryesore: *qytetari*, *qytetaria* dhe *pjesëmarrja qytetare*, të cilat mund të arrihen përmes të mësuarit nga praktika, përfshirjes së pjesëmarrjes qytetare në kurrikulën arsimore, menaxhimit shkollë-komunitet dhe vendosjes së pjesëmarrjes qytetare si standard i shekullit XXI.

Masteri shkencor **Shkencat e edukimit** ofron²¹ shumë kurse të përputhshme me parimet e EQD-së. Përmes kurseve *Edukimi multikulturor*, *Teoritë moderne të edukimit*, *Modelet e mësimdhënies*, *Teoritë e të nxënësve*, *Kurrikula e shkollës dhe organizimi i shkollës*, mësuesit-studentë njihen gjerësisht me parimet dhe standardet e EQD-së. Nga analiza e kurrikulës së shkruar, rezultojnë që studentët fitojnë njohuri mbi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut/fëmijëve; ato kanë mundësi të thellohen në konceptet e demokracisë, qytetarisë dhe pjesëmarrjes në shkollë dhe në shoqëri; ata udhëzohen/u kërkohet të mendojnë në mënyrë kritike dhe konstruktive, të jenë të hapur ndaj mjediseve të ndryshme kulturore dhe të vlerësojnë diversitetin; të ofrojnë ndihmë si profesionistë përmes qasjeve, metodologjive me në qendër fëmijët dhe praktikave gjithëpërfshirëse dhe interaktive.

Të gjithë masterat profesionalë kanë të paktën një kurs tejet të përputhshëm me parimet e EQD-së; ata janë: *Filozofia e integritit evropian*, *Filozofia e të drejtave*, *Edukimi për demokraci*, *Filozofia e shtetit dhe e demokracisë*, *E drejta dhe shoqëria*, *Menaxhimi i konflikteve*, *Barazia gjinore*, *Mbrojtja e fëmijëve*, *Shkolla dhe shoqëria*, *Edukimi gjithëpërfshirës etj.*

Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë

Departamentet që formojnë profesionistë në mësimdhënie për arsimin e mesëm të ulët dhe të lartë, janë:

- ▶ Departamenti i Gjuhësisë,
- ▶ Departamenti i Letërsisë,
- ▶ Departamenti i Historisë,
- ▶ Departamenti i Gjeografisë.

Masteri profesional **Mësuesi në Gjuhë Letërsi**²²

Metodologjitë e mësimdhënies (5 ECTS) është kurs i detyrueshëm që zhvillon kompetencat e mësimdhënies me në qendër fëmijën dhe të menduarin kritik në edukim. *Vlerësimi i nxënësve* (3 ECTS) është një tjetër kurs i përshtatshëm me parimet e EQD-së, i cili nxit përfshirjen e nxënësve në rezultatet e të nxënësve, përfshirjen prindërore, teknikat e vlerësimit me në qendër fëmijën/nxënësin etj.

Masteri profesional **Mësuesi në Gjeografi**: *Teoritë e të nxënësve* (6 ECTS), *Vlerësimi i nxënësve* (6 ECTS), *Metodologjitë e mësimdhënies dhe të menduarit kritik* (8 ECTS),

21. Kurset nuk përshkruhen në mënyrë të detajuar, me qëllim që të shmangët përsëritja e koncepteve të mësipërme.

22. Të dy masterat përgatisin mësues vetëm për nivelin e arsimit të mesëm.

Mësimdhënia dhe etika profesionale (4 ECTS) janë të gjitha kurse të detyrueshme të ofruara gjatë vitit të parë dhe të dytë, në përputhje me standardet e EQD-së. Mësuesit-studentë zhvillojnë kompetenca, të tilla si: qasjet me në qendër fëmijën, të drejtat e fëmijëve, të menduarin krijues dhe kritik, si dhe metodologjitë e mësimdhënies me në qendër fëmijën.

9. PRAKTIKA PROFESIONALE GJATË TRAJNIMIT PARA SHËRBIMIT

Një nga pyetjet studimore ka të bëjë me mundësitë e zbatimit praktik të EQD-së/EDNJ-së gjatë përgatitjes para shërbimit.

Dokumentet e KIE-së për EQD-në theksojnë se është shumë e rëndësishme që t'i jepet mundësi mësuesve-studentë për të demonstruar dhe për të përmirësuar kompetencat e tyre si mësues të ardhshëm. Përgjatë viteve të trajnimit para shërbimit, kjo është bërë e mundur përmes praktikës së mësimdhënies (praktikës profesionale). Qëllimi kryesor i praktikës së mësimdhënies është që mësuesit-studentë t'u mundësohet që të praktikojnë dijet teorike drejtpërdrejt në mësimdhënie në shkolla të arsimit parauniversitar. Përgjatë praktikës së tyre të mësimdhënies, mësuesit-studentë pajisen me përvoja thelbësore, që mund të çojnë në zhvillim të kompetencave të tyre. Ata kanë mundësi që të zhvillojnë veprimtari të larmishme me nxënësit në shkolla, duke i ndihmuar kështu ata të zotërojnë dhe të praktikojnë të gjitha parimet, aftësitë dhe vlerat, në mënyrë që të bëhen mësues profesionistë.

Praktika profesionale në Shqipëri konsiderohet pjesë thelbësore dhe përbërëse e edukimit fillestar të mësuesit dhe planifikohet në mënyrë progresive gjatë gjithë programit. *Praktika profesionale* zakonisht bëhet në semestrin e fundit të programeve Bachelor dhe master dhe përfshin deri në 10%²³ të programit të përgjithshëm arsimor. Ajo realizohet në shkollat e arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë. Lidhja mes universiteteve dhe shkollave gjatë praktikës profesionale nuk është e rregulluar zyrtarisht nga MAS-i. Monitorimi dhe vlerësimi i praktikës profesionale është kompleks e shoqërohet me problematika të shumta.

Në të gjitha programet e analizuara Bachelor dhe Master, *Praktika e mësimdhënies* bëhet kryesisht në semestrin e fundit të vitit të fundit, me disa përjashtime, të cilat zbatojnë një strukturë më të integruar praktike, siç është rasti i Universitetit të Elbasanit. Në të gjitha rastet, marrëveshjet bëhen në partneritetet mes drejtorive arsimore rajonale dhe shkollave. Kreditet për këtë kurs variojnë sipas fakulteteve, nga 10–20 ECTS. Vlen të theksojmë se të gjitha programet e kanë praktikën e mësimdhënies pjesë të kurrikulës së tyre.

Në bazë të rregullores “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, datë 22.10.2009, përkufizimi i Praktikës profesionale (praktikës së mësimdhënies) për profesionin e rregulluar të mësuesit është: “*ushtrimi i profesionit të mësuesit nga praktikanti, nën drejtimin dhe përgjegjësinë e mentorit dhe realizohet për të fituar të drejtën e hyrjes në provimin e shtetit*”. Pavarësisht përkufizimit të qartë, në praktikë ekzistojnë disa hendeqe funksionale.

23. Raport për arsimimin e mësuesve para shërbimit në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri, IZHA, 2016.

Sipas intervistave, problemet kryesore dalin nga ndryshimet e herëpashershme strukturore të agjencive të lidhura me arsimin parauniversitar dhe nga roli e përgjegjësitë e mësuesve-mentorë përgjatë gjithë procesit të praktikës profesionale. Gjithashtu, shpesh, mësuesit-studentë neglizhohen nga mentorët e tyre, të cilët nuk bëjnë vëzhgimet e duhura në klasë ose nuk marrin asnjë *feedback* nga ato. Praktika të tilla mund ta komprometojnë rëndë procesin e vlerësimit.

Marrëdhënia me shkollat dhe vlerësimi i saj mbetet sfidues. Sipas intervistave, numri i mësuesve-studentë të shpërndarë në shkolla është relativisht i lartë në krahasim me kapacitetet e shkollave. Problemi bëhet edhe më i madh duke marrë parasysh nevojën për praktikë profesionale në të dyja nivelet (*Bachelor* dhe *master*), si dhe larminë e mësuesve të të gjitha disiplinave. Për ta zbutur këtë problem, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, i Universitetit të Tiranës, i shpërndan mësuesit-studentë në shkolla sipas qytetit të tyre të lindjes, pra jo vetëm në shkollat e Tiranës, por edhe në shkollat e të gjithë vendit.

Sipas *fokusgrupeve*, gjatë praktikës profesionale ka një hendek real mes njohurive dhe aftësive praktike të studentëve. Mësuesit-studentë nuk janë të familjarizuar me kurrikulën me bazë kompetencat dhe nga ana e mësuesve të shkollave (dhe mentorët, kur janë të pranishëm) duhen përpjekje të mëdha që t'i fusin ata në menaxhimin e mësimin. Sipas përgjigjeve të marra nga tryezat e rumbullakëta, mësuesit-studentë, që bëjnë praktikën profesionale në shkollë, janë të mirëpërgatitur nga pikëpamja shkencore, por u mungojnë aftësitë thelbësore sa i përket metodologjisë.

10. PËRFUNDIME

Zhvillimi i kurrikulës akademike në përputhje me edukimin për qytetari demokratike dhe edukimi për të drejtat e njeriut në Shqipëri nxitet nga:

- a) kërkesa sistematike e arsimit parauniversitar për mësues të kualifikuar me kompetenca EQD;
- b) përparësitë globale në arsim: KiE-ja, UNESCO-ja etj.;
- c) hendeku i krijuar në fakultete, i cili, prej masivizimit të arsimit të lartë, nuk iu përgjigj nevojave të arsimit parauniversitar.

Institucionet arsimore i kushtojnë vëmendje të veçantë përfutimit të *kompetencës për qytetari*, si një nga kompetencat kyçe të të mësuarit gjatë gjithë jetës. Njohuritë dhe vlerat e mësuarat bëjnë që studentët të mbajnë qëndrime të shëndetshme, që pasqyrohen më pas në sjelljen e tyre, dhe në bazë të të cilave ndërtojnë sistemin e tyre të vlerave. Studentët krijojnë marrëdhënie me të tjerët, kuptojnë dhe respektojnë ndryshimet, marrin pjesë në mënyrë aktive në klasë, universitet dhe komunitet.

Në bazë të përgjigjeve të marra nga intervistat dhe tryezat e rrumbullakëta, vendosja e notës mesatare 7.5, si kriter pranimi në fakultetet me drejtim në mësimdhënie, ka ulur ndjeshëm numrin e studentëve që studiojnë në këto programe – sidomos në universitetet e rretheve. Kjo vërehet në çdo fakultet, përveçse në atë të Tiranës. Në institucionet e arsimit të lartë në rrethe, mungesa e kërkesës për të studiuar këto programe, për shkak të përcaktimit të mesatares hyrëse, po çon drejt tkurrjes ose dhe mbylljes së tyre.

Sa i përket kurrikulës së shkruar zyrtare në fakultetet e mësimdhënies, mund të dalim në përfundimin se *përmbajtja kurrikulare ka favorizuar zhvillimin e politikave të lidhura me EQD-në*. Ndonëse kurrikulat janë shumë të ndryshme nga një fakultet në tjetrin, ato miratojnë parimet e EQD-së/EDNJ-së. Shumica e kurseve përputhen me standardet dhe parimet e EQD-së. Zyrtarisht dhe formalisht, kurrikula ofron mundësi për zhvillimin e lëndëve ekzistuese, për futjen e kurseve të reja dhe për krijimin e politikave universitare në nivel kombëtar. Ky është një fillim i mirë për krijimin e mundësive të mëtejshme për reformimin e sistemit të arsimit të lartë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Problemet kryesore gjenden në fushën e pedagogjisë, e cila përgjithësisht nuk është në përputhje me standardet e EQD-së. Pavarësisht ndërgjegjësimit ndaj rëndësisë së edukimit joformal, duke përfshirë kurset e EQD-së, shumica e udhëzimeve të mësimdhënies në universitete janë formale dhe tradicionale, me profesorët që ligjërojnë si figura qendrore e klasës dhe studentët si pjesëmarrës aktivë. Përpjekjet duhet të përqendrohet te zhvillimi i pedagogjisë së duhur që mbështet metodologjinë e EQD-së/EDNJ-së.

Në bazë të datës së krijimit të kurseve në të tria fakultetet e edukimit, mbi 70% e lëndëve të analizuar u futën pas vitit 2012 dhe disa të tjera në vitin 2018. Në bazë të kësaj reference, mund të dalim në përfundimin se vetëm mësuesit “e rinj” (praktikisht ata të diplomuarit pas viteve 2015/2016) kanë marrë njohuri EQD/EDNJ

dhe për këtë arsye ekziston edhe hendeku mes tyre dhe mësuesve më të vjetër e me më shumë përvojë pune.

Struktura e programeve mësimore përbëhet nga trajnimi i përgjithshëm psiko-pedagogjik dhe trajnimi i specializuar mbi didaktikën dhe përmbajtjen shkencore të kursit, i cili ka peshën më të lartë të ECTS-së. Vlerësimi i studentëve organizohet përmes metodave të shumta të detyrave individuale e në grupe dhe praktikës profesionale/në laborator etj. Provimi përfundimtar ka peshën më të lartë në krahasim me elementet e tjera. Megjithatë, ekziston prirja e përfshirjes së komponentit të aftësive praktike në vlerësimin e studentit përmes provimit përfundimtar, të shprehur në formën e eseve, projekteve të kurseve ose detyrave të tjera të dhëna nga pedagogu i lëndës.

Praktika profesionale konsiderohet pjesë thelbësore e integruar e programit në edukimin fillestar të mësuesve në Shqipëri. Ajo planifikohet duke marrë parasysh rritjen në mënyrë progresive të vështirësive të saj dhe zakonisht zhvillohet në semestrin e fundit të programit të studimit.

Në bazë të intervistave me pedagogët e fakulteteve të mësuesisë, shumica mendojnë se programet e tyre janë cilësorë dhe efektivë. Ata pohojnë se i kanë përmirësuar e përditësuar programet, gjë që ka rezultuar efektive.

11. REKOMANDIME

Unifikimi i kurrikulës duhet të vazhdojë dhe të përfundojë, duke vënë theksin veçanërisht mbi përmbajtjen e saj, në mënyrë që t'i shërbejë më mirë nevojave të arsimit parauniversitar. Në përputhje me ligjin për arsimin e lartë në Shqipëri, duhet që kurrikulat e programeve të ciklit të dytë për përgatitjen e mësuesve, të unifikohen në nivel kombëtar 80%, në bazë të disiplinës shkencore përkatëse. Megjithatë, ligji u siguron institucioneve të arsimit të lartë pavarësi dhe një unifikim i tillë mund të cenojë parimin e autonomisë. Në bazë të përgjigjeve të marra nga tryezat e rrumbullakëta, unifikimi i programeve në 80% mund të mos jetë i mundur, pasi është në varësi të secilit institucion të arsimit të lartë që të rregullojë programet e tij, të diversifikojë programet, përmbajtjen dhe cilësinë e tyre. Unifikimi i programeve, gjithashtu, mund të rrezikojnë e zerojë konkurrencën mes institucioneve të arsimit të lartë. Ndaj, një rekomandim i këtillë i nënshtrohet shqyrtimit të mëtejshëm të aktorëve institucionalë të përfshirë në politika dhe vendimmarrje rreth arsimit publik në vend.

Teoria mbi EQD-në/EDNJ-në është e lidhur në mënyrë të pandashme me *pedagogjinë*. Kurrikula zyrtare në arsimin e lartë ofron potencial të madh, por duhet të shoqërohet me investim të konsiderueshëm në pedagogji në përputhje me parimet e EQD-së/EDNJ-së. Në këtë mënyrë, kurrikula kthehet në një instrument për krijimin e kompetencave për kulturë demokratike. Ndërveprimet në klasë, angazhimit në projekte dhe praktikave të EQD-së duhet t'u jepet më shumë hapësirë në të gjitha ciklet e studimit. Institucionet e arsimit të lartë mund të mbështesin qasjet, risitë dhe karakteristikat e kurrikulës së reformuar me bazë kompetencat në edukimin parauniversitar.

Praktikat e suksesshme të mësimdhënies kërkojnë *mentorë-mësues të suksesshëm* me një rol tepër të rëndësishëm. Mësuesit-studentë, profesorët e universitetit dhe mentorët-mësues duhet të formojnë një trekëndësh, i cili më pas do të rrisë cilësinë e praktikës së mësimdhënies në përputhje me EQD-në. Mentorët-mësues duhet të shihen si partnerë të profesorëve të universitetit. Mentorët-mësues i kthejnë klasat e tyre në mikroshoqëri ku të kultivohet kultura demokratike. Nëse praktika e të nxëniet ka pak ose aspak ndikim në themelet e demokracisë së zbatuar, studentët nuk do të jenë të përgatitur mjaftueshëm për t'u bërë qytetarë demokratikë. Në këtë mënyrë, mentorët dhe profesorët e universiteteve duhet t'i mbështesin mësuesit-studentë që t'i çojnë më tej njohuritë e tyre mbi profesionin dhe rolin e tij në shoqëri. *Promovimi i programeve të mentorimit dhe përmirësimi i rolit të mentorëve-mësues* si ekspertë në të nxëniet praktik dhe kritik të kolegëve e mësuesve-studentë të tyre, janë të një rëndësie të madhe për EQD-në. Mentorët-mësues duhet të certifikohen në mënyrë që të kenë zyrtarisht pozicionin e mentorit-mësues. Aktualisht, në Shqipëri mungojnë certifikime për mentorë-mësues në arsimin e lartë dhe atë parauniversitar. Certifikimet duhet të ndiqen nga kualifikimet (që pothuajse nuk ekzistojnë) e duhura rreth mentorimit dhe mënyrave për të qenë një mentor i mirë e i suksesshëm.

Konceptet e EQD-së/EDNJ-së duhet të merren në konsideratë dhe të trajtohen sipas një qasjeje më ndërkulturore dhe ndërdisiplinore. *Edukimi për qytetari* duhet të jetë i pranishëm edhe në lëndë të tjera, si: matematika, fizika dhe shkenca të tjera.

Qytetaria është kryesisht një qasje, një sjellje, një qëndrim dhe, pikërisht, duke pasur këtë në konsideratë, u mundësohet mësuesve të fokusohen te krijimi i një modeli mësimdhënieje me në qendër nxënësin.

Duke qenë se trajnimi teorik në universitete përfshin partneritetin e shkollave dhe duke pasur parasysh faktin se profesioni nuk mund të zotërohet nëse teoria nuk zbatohet në praktikë, atëherë universitetet duhet të investojnë në *krijimin e sistemeve të monitorimit të praktikës së mësimdhënies*, në mënyrë që trajnimi i mësuesve para shërbimit të jetë i suksesshëm. *Gjithashtu, duhet të zhvillohen kapacitetet e pedagogëve sa u përket programeve të mësimdhënies, me qëllim që të zbatohet modeli i përgatitjes së mësuesve në bazë të kurrikulës së kompetencave.*

Nevojat e trajnimit të mësuesve duhet të vlerësohen me qëllim mbështetjen e ndërhyrjeve në prova faktike. Gjithashtu, universitetet duhet të luajnë një rol edhe më mbështetës ndaj trajnimit të mësuesve në shërbim në lidhje me EQD-në dhe EDNJ-në. Nevoja për vendosjen e lidhjeve mes arsimit universitar dhe atij parauniversitar u artikulua shumë në të gjitha tryezat e rrumbullakëta të organizuara nga projekti. Për vendosjen e këtyre lidhjeve të nevojshme me shkollat mund të organizohen konferenca, veprimtari ose tryeza të rrumbullakëta të përbashkëta mes fakulteteve të mësuesisë dhe shkollave. Gjithashtu, mund të organizohen edhe veprimtari jashtëkurrikulare për qytetarinë demokratike, siç janë shkollat dimërore me pjesëmarrjen e mësuesve-studentë, duke përfshirë shkollat fillore dhe ato të mesme.

Institucionet e arsimit të lartë kanë kapacitetin dhe burimet e nevojshme për t'u përfshirë dhe për të kontribuar në procesin e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesve. Universitetet mund të kthehen në një prej aktorëve më të rëndësishëm të krijimit dhe të zhvillimit të trajnimeve në fushat e përmbajtjes, mësimdhënies dhe të nxënit shkencor, vetëm pasi të pajisen me aftësi kurrikulare të bazuara në kompetenca. Pengesat ekzistuese administrative të përfshirjes së universiteteve në trajnimin e mësuesve duhet të zbuten me qëllim që të krijohen dhe mirëmbahen lidhjet e nevojshme mes universiteteve dhe shkollave.

Krijimi i një dokumenti rregullator mes universiteteve dhe shkollave për organizimin e praktikës profesionale është i nevojshëm. Një dokument i tillë strategjik do të organizonte formalisht marrëdhënien mes universiteteve dhe shkollave, do të përcaktonte rolet dhe përgjegjësitë, do të organizonte procesin e vlerësimit dhe do të shërbente për përfshirjen e mëtejshme të të gjithë procesit të trajnimit fillestar të mësuesve në praktikën profesionale dhe në zhvillimin e vazhdueshëm profesional.

Veprimtaritë dhe politikat e fakulteteve të edukimit mund të harmonizohen më tej me EQD-në/EDNJ-në. Kjo mund të bëhet duke rritur nevojën për EQD përmes konsolidimit dhe rritjes së *nismave ekzistuese* po dhe *krijimit të të rejave*. Gjithashtu, këshillohet që universitetet të krijojnë programe të specializuara studimi që i kushtohen *edukimit për qytetari demokratike dhe edukimit për të drejtat e njeriut*.

Ofertat akademike të universiteteve për EQD-në/EDNJ-në duhet të zgjerohen deri në nivelin e *programeve të doktoraturave* përmes promovimit efektiv dhe mundësive për kërkim shkencor.

12. BIBLIOGRAFIA

- *Edukimi për qytetari në shkolla në Evropë*, Agjencia Ekzekutive për Arsimin, Kulturën, Mediat Audiovizuale, 2017
- *Instrumenti për sigurimin e cilësisë së EQD-së në shkolla*, César Bîrzea, Michela Cecchini, Cameron Harrison, Janez Krek, Vedrana Spajić-Vrkaš, 2005
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Karta e Këshillit të Evropës për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe Edukimin për të Drejtat e Njeriut, e miratuar në kuadër të Rekomandimit KM/ Rek. (2010)7 të Komitetit të Ministrave
- Kuadri i Referencës i Kompetencave për Kulturë Demokratike (vëllimi 3), Këshilli i Evropës
- Ligji për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, nr. 80/2015
- Mbështetja e zhvillimit të kompetencave të mësuesve për rezultate më të mira mësimore, KiE, korrik 2013
- Perceptimet e mësuesve mbi edukimin për qytetari demokratike në shkollat me të rinj ndërkombëtarë: një studim krahasues në MB dhe Danimarkë, Carole L. Hahn, 2015
- Qeverisja Demokratike e Shkollave Elisabeth Bäckman dhe Bernard Trafford, Këshilli i Evropës, janar 2007
- Raporti për Reformimin e Arsimit të Lartë në Shqipëri, Komisioni për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, korrik 2014
- Raport për edukimin e mësuesve para shërbimit në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri, IZHA, 2016
- Strategjia Kombëtare për Arsimin e Lartë (SCALA 2008-2013)

Burime online

<https://www.coe.int/en/web/education/programme>

<https://www.ascal.al/sq/>

<https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000259245>


<https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/fakulteti-i-edukimit/>

<https://unitir.edu.al/fakulteti-i-shkencave-sociale/>

Për më tepër informacion:

 <https://www.coe.int/sq/web/tirana/home>

 Council of Europe Office in Tirana

 coe_tirana

Lista e të intervistuarve

Armando Shëngjergji	Përgjegjës i Departamentit për Qytetarinë, Fakulteti i Shkencave të Edukimit, Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan
Astrit Dautaj	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar
Elda Gjergji	Pedagoge e lëndës për të Drejtat e Fëmijëve, Fakulteti i Shkencave të Edukimit, Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan
Florinda Tarusha	Përgjegjës i Departamentit të Metodologjisë së Mësimdhënies, Fakulteti i Shkencave të Edukimit, Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan
Griselda Abazaj	Dekane e Fakultetit të Edukimit, Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës
Kozeta Noti	Pedagoge në Departamentin e Pedagogjisë dhe Psikologjisë, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës
Lili Sula	Përgjegjëse e Departamentit të Letërsisë, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Universiteti i Tiranës
Lindita Lutaj	Pedagoge e lëndës së Edukimit për Qytetari, Departamenti i Pedagogjisë, Fakulteti i Edukimit, Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës
Nada Kallçiu	Pedagoge në Departamentin e Pedagogjisë dhe Psikologjisë, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës
Ornela Bilali	Pedagoge e lëndëve Metodologji të Mësimdhënies, Fakulteti i Shkencave të Edukimit, Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 47 shtete anëtare, duke përfshirë të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

www.coe.int

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE